

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktorë - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7621 E mërkurë 15 Gusht 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **Ditës**

Turizmi është konsideruar gjithmonë prioritet në Shqipëri. Vit pas viti hartohen politika zhvillimi për të përthithur sa më shumë turistë vendës dhe të huaj. Pozicioni... *Vijon në faqen 20*

Nga DR. SORINA KOTI

Turizmi dhe pushteti lokal



Opinion **Ditës**

Më 8 - 12 gusht u organizua për të 12 vit radhazi Festa tradicionale "Birra Korça". Ajo përkoj me 90-vjetorin e fillimit të prodhimit të kësaj marke emblematike... *Vijon në faqen 21*



Nga DR. JORGJI KOTE

Nga "Birra Korça Fest", te diplomacia kulturore



Tregjedia në Xhenova, nuk ka shqiptarë

35 të vdekur nga shembja e urës në Itali. Kompania, projekte në Shqipëri

Firma italiane që ndërtoi objektin u përfshi para gjashtë muajsh në një skandal korruptiv

Nga PAMELA ALIAJ

Ura që u shemb në Xhenova është lidhësja kryesore autorrugore e qytetit. Ajo lidh autostradën A10 me hyrjen e perëndimit të Xhenovës, në të cilën shkohet për në portin e mallrave dhe terminalin e trageteve për në ishujt e për në kroçierat, dhe me A7 për në Milano...

Në faqet 2-3

EMRAT/ 470 TRASHEGIMTARET QE MARRIN PARATE, LISTA E PERFITUESVE

TE PERNDJEKURIT, KUSH E FITON DEMSHPERBLIMIN

Ish-të dënuarit e diktaturës që marrin paratë. Kush e ka emrin në listë duhet të dorëzojë numrin e llogarisë bankare brenda muajit qershor



(Në foto) Ish-të përndjekur gjatë një proteste

SHMANGET TRAGJEDIA

Rrëfimi i fierakut: Gruaja na dogji shtëpinë, tentoi të mbyste 2 vajzat

Në faqen 4

MINISTRJA E MBROJTJES

Olta Xhaçka: Ja çfarë më vë në siklet para ushtarakëve

Në faqet 6-7

LISTA E RE

Buxheti, 15 miliardë lekë për pronarët, përfituesit në të gjithë vendin

Në faqen 22

TRASHEGIMIA

Mozaiku në këmbët e xhamisë, Meksi: "Bazilika" daton që nga shekulli i parë

Në faqen 19

INTERVISTA



Ahmet Prenci: Të amendohet ligji "Antimafia" për 'peshqit e mëdhenj'

Në faqet 8-9

Nuk pranoi burrin që i gjeti fisi, shteti e rregulloi vlonjaten në Shkodër

Donte ta vriste familja, si u shpëtua vajza më 1929

Përpjekjet e institucioneve të Mbretërisë për të mbrojtur jetën e të resë

Nga FATMIRA NIKOLLI

Ju lajmërojmë se kemi nevojë të sigurojmë jetën e një gruaje të quajtur XXXX nga Vlora, e cila ndiqet prej afërsies së saj pse ajo nuk është martue me atë burrë që i kanë propozuar prindërit, por ka dashur të vejë kunorë me një tjetër



person me të cilin ka pasur relacione më përpara. Për këtë çështje jemi marrë vesh me Prefekturën e Shkodrës, e cila na siguron se po të urdhënojë ajo Drejtorin e Drejtorinë e Spitalit të Shkodrës mund t'i sigurohet kësaj jeta duke e marrë në shërbim si...

Në faqet 18-19

TRAGJEDIA NË ITALI DETAJET

INAUGURIMI I URËS



Ura që u shemb në Xhenova është lidhësja kryesore autorrugore e qytetit. Ajo lidh autostradën A10 me hyrjen e perëndimit të Xhenovës, në të cilën shkohet për në portin e mallrave dhe terminalin e trageteve për në ishujt e për në kroçierat, dhe me A7 për në Milano. Pikërisht për këtë funksion, ura është shpesh e përfshirë nga një trafik që zgjat. E inauguruar në 1967, ajo ka qenë shpesh objekt diskutimi dhe objekt i punimeve për mirëmbajtje ndër vite.

REAGIMI I BERLUSKONIT



"Po ndjek me trishtim të thellë lajmin për dramën që ndodhi në Xhenova. Mendimet e mia të ndjera shkojnë për viktimat, familjet e tyre dhe të plagosurve. Jam pranë tyre. Dua t'u shpreh mirënjohjen time zjarrfikësve dhe të gjithë personelit që është angazhuar për të shpëtuar jetë njerëzish. Tani për tani, i gjithë vendi duhet të jetë në një anë, duke lënë mënjanë polemikat e çdo lloji", tha ish-kryeministri italian.

REAGIMI I KRYEBASHKIAKUT TË XHENOVËS



"Rënia e urës 'Morandi' është një tragjedi për qytetin tonë. Qyteti nuk është gjunjzuar, do dijë të reagojë. Qyteti do të dijë të vijojë rrugën e tij të rritjes", ka thënë kryebashkiaku, Marko Bucci.

Tragjedia në Itali, ja dëshmitë e të mbijetuarve nga katastrofa

Shembet ura e "ferrit" në Itali, humbin jetën 35 veta

Shembet pikëlidhja e Xhenovës, 20 të plagosur e 10 të humbur

Pamela Aliaj

Ditën e djeshme mund të thuhet se ndodhi një nga tragjeditë më të rënda në vendin fqinj prej më shumë se disa dekadash. Për shkaqe ende të paidentifikuara, të martën e 14 gushtit, në autostradën A10 në Xhenova është shembur ura e ashtuquajtur 'Morandi', e cila u ka marrë jetën 35 personave. Më shumë se 300 punonjës të shërbimit të zjarrfikës janë aktualisht në terren, ndërsa gërmojnë pa pushim për të gjetur të tjerë njerëz që mund t'i kenë mbijetuar tragjedisë së djeshme në Xhenova. Mësohet se 92 automjete janë vendin ku u shemb ura 'Morandi', ndërsa kërkimet do të vijojnë edhe përgjatë natës, shkruan 'Tg-com'. Mediat italiane raportojnë se 10 persona rezultojnë të zhdukur. Ndërkohë, në spitalin e San Martinos aktualisht ndodhen të afërm të viktimave, të cilët bëjnë të mundur edhe identifikimin e trupave të pajetë, ndërsa numri i tyre ka shkuar në 35. Mes



Pamje nga ura e shembur në Xhenova

aktivizuar njësitë e qenve për të kryer kërkime. Dhjetëra telefonata kanë mbërritur në policinë italiane, ndërsa fotot janë postuar në "Facebook". Dyshohet se ajo që ka shkakuar shembjen e urës mund të ketë qenë një kolaps strukturor, që ka ndodhur në pjesën që kalon mbi rrugën "Walter Fillak" në zonën e Sampierdarena. Të dyja karrexhatat kanë rënë në tokë për rreth njëqind metra. Në orën 10:35 një rrufe goditi bazën e një shtylle. Menjëherë betoni filloi të shkrëmoqet dhe më pas çdo gjë u rrëzua dhe ndodhi fundi i botës". Një familje me katër persona në gjendje shoku tregon se pa në orën 10:30 një rrufe të godiste bazën e kolonës. Ndoshta është sugjerim, ose ndoshta një udhë e mundshme për të gjetur shkaqet e kolapsit. "E pamë strukturën të shembje dhe pastaj një kamion fluturoi në humbëtitë", thonë dëshmitarët. Ndërkohë që një kamion ka ndaluar vetëm pak metra larg pjesës së shkëputur të urës 'Morandi' në Xhenova. Shoferi që ndodhej brenda mund ta konsiderojë veten me fat që i ka shpëtuar

turës dhe Transportit, Danilo Toninelli. "Po e ndjekim minutë pas minute situatën e shembjes së urës në Xhenova, falënderoj deri tani 200 zjarrfikësit dhe të gjithë heronjtë e tjerë që po punojnë për të shpëtuar jetë", shkroi ministri i Brendshëm, Matteo Salvini në "Facebook". Bëhet fjalë për urën "Morandi", që lidh Xhenovën Perëndimore me Ligurian. Një pjesë e urës ka rënë mbi banesa e objekte të tjera. Në vend kanë shkuar një numër i madh ambulancash, zjarrfikësish dhe forcash policie. "Corriere" shkruan se ka persona nën rrënoja dhe janë

aktivizuar njësitë e qenve për të kryer kërkime. Dhjetëra telefonata kanë mbërritur në policinë italiane, ndërsa fotot janë postuar në "Facebook". Dyshohet se ajo që ka shkakuar shembjen e urës mund të ketë qenë një kolaps strukturor, që ka ndodhur në pjesën që kalon mbi rrugën "Walter Fillak" në zonën e Sampierdarena. Të dyja karrexhatat kanë rënë në tokë për rreth njëqind metra. Në orën 10:35 një rrufe goditi bazën e një shtylle. Menjëherë betoni filloi të shkrëmoqet dhe më pas çdo gjë u rrëzua dhe ndodhi fundi i botës". Një familje me katër persona në gjendje shoku tregon se pa në orën 10:30 një rrufe të godiste bazën e kolonës. Ndoshta është sugjerim, ose ndoshta një udhë e mundshme për të gjetur shkaqet e kolapsit. "E pamë strukturën të shembje dhe pastaj një kamion fluturoi në humbëtitë", thonë dëshmitarët. Ndërkohë që një kamion ka ndaluar vetëm pak metra larg pjesës së shkëputur të urës 'Morandi' në Xhenova. Shoferi që ndodhej brenda mund ta konsiderojë veten me fat që i ka shpëtuar



DANILO TONINELLI
"Po e ndjek me shqetësim situatën në Xhenova dhe që me sa duket, është një tragjedi e madhe. Jemi në kontakt të ngushtë me autostradat dhe po shkojmë në vend me zëvendësministrin Rixi. Ndodhem pranë qytetit në këto orë", shkroi në "Twitter" ministri i Infrastrukturs dhe Transportit, Danilo Toninelli.



MATTEO SALVINI
"Po e ndjekim minutë pas minute situatën e shembjes së urës në Xhenova, falënderoj deri tani 200 zjarrfikësit dhe të gjithë heronjtë e tjerë që po punojnë për të shpëtuar jetë", shkroi ministri i Brendshëm, Matteo Salvini në "Facebook".

për fije të perit tragjedisë. Nderkaq ajo që tërheq akoma më tepër vëmendjen është se rajoni i Ligurias sipas parashikimeve meteorologjike dhe hidrologjike i ka deklaruar shtetit alarm të verdhë për stuhitë nga ora 15 deri në orën 18 të ditës së djeshme në territorin e komunës së

Xhenovës. Pra, është parashikuar një gjendje gjysmë-alarmante, e cila do të çonte më vonë në katastrofën e djeshme të shembjes së urës, gjë e cila për fat të keq nuk mundi të evitohet duke shkaktuar dhjetëra të vdekur e të plagosur.

Alban Daci: Tek ajo urë janë bërë gjithnjë punime. Pasagjerët mbetën të bllokuar

Flet shqiptari në Xhenova: Ajo urë ka qenë gjithnjë e frikshme

Gazetari rrëfen momentet e tmerrit pas shembjes

Pamela Aliaj

Ngjarja e ndodhur ditën e djeshme në Xhenova të Italisë është një ndër katastrofat dhe tragjeditë më të mëdha të ndodhura prej 1 shekulli në vendin fqinj. Kështu shprehet në intervistën ekskluzive për "Gazeta Shqiptare", gazetari Alban Daci, i ndodhur në vendngjarje. Ai rrëfeu ndër të tjera edhe momentet e tmerrit të kaluara nga që nga momenti i shembjes së urës. "Thonë se janë dëgjuar ulërima njerëzish në momentin e shembjes", është shprehur Daci.

Ju ishit i pranishëm në vendngjarje? Mund të na thoni se çfarë patë, çfarë ndodhi? A u ndonjë lëkundje apo lëvizje e urës para se ajo të shembej?

Ura ka rënë menjëherë, pa pasur lëkundje. Dhe siç ka qenë me intensitet të lartë trafiku, mendohet se bashkë me urën kanë rënë 20 makina. Numri i viktimave është në rritje. Deri tani ka arritur në 35. Dyshohet edhe për dy shqiptarë të humbur. Por nuk ka të dhëna konkrete, sepse autoritetet janë të impenjuara për shpëtimin e personave.

Keni informacion për emrat e shqiptarëve të humbur?

Prefektura ka vënë në shërbim kontaktet për të humburit dhe për informacione. Kam, por nuk dua t'i publikoj, sepse nuk është asgjë e konfirmuar për të mos krijuar situata të pakëndshme tek familjarët. Nuk ka asgjë të konfirmuar për momentin.

A janë bërë ndërhyrje më parë tek kjo urë?

Në atë urë janë bërë vazhdimisht punime.

A kishte më parë lëkundje këto ditë për shkak të kohës ura? Parashikohej një shembje e tillë?

Gjithmonë ka pasur një frikë të qytetarët. Madje/njëra komenton se gjithmonë ka kaluar me frikë dhe i dukej se do të shembje. Nuk dihen shkaqet e shembjes/por mendohet amortizimi. Megjithatë, në ditët në vazhdim pritet një raport nga autoritetet kompetente.

Pse sipas jush, u shemb në kohë që bëheshin punime?

Ndoshta për shkak të temperaturave të larta dhe fluksit të madh të makinave. Sepse



AVOKATI SAJMIR VISHAJ

Vetëm nëntë minuta kanë bërë që avokati shqiptar, Saimir Vishaj të shpëtonte nga tragjedia e Xhenova ditën e djeshme. Në një postim në rrjetet sociale avokati i njohur falënderon Zotin. "Faleminderit Zoti im! Mbas 9 minutash ndodhi tragjedia këtu në Xhenova", shkruan Vishaj në faqen e tij në "Facebook".

Ndërtoi urën në Xhenova, kompania e përfshirë në skandal korruptiv. Ja projekti që i besoi qeveria shqiptare

Kompania që ndërtoi urën Morandi në Xhenova, "Condotte SPA", e cila u shemb ditën e djeshme, duke shkakuar 35 viktima dhe dhjetëra të plagosur, 6 muaj më parë u përfshi në një skandal korruptiv në Itali. Kështu, më 13 mars të këtij viti presidenti i kompanisë, Duçio Astaldi bashkë me 5 zyrtarë të tjerë u prangosën për korrupsion, pasi u akuzuan për abuzime për ndërtimin e tri pjesëve të autostradës Sirakuzaxhela. Siç raportoi në atë kohë mediat italiane, 6 të arrestuarit u përfshinë në një hetim për rryshfet, ndërsa u zbulua se Komisioni i Vlerësimit të Ofertave kishte kryer procedura fiktive, ndërsa fituesi ishte përcaktuar më herët. Në një kohë kur sot partitë opozitare në Itali kanë kërkuar që përgjegjësit për tragjedinë në Xhenova të dalin para drejtësisë, kujtojmë se "Condotte SPA" është një kompani që ka kryer dhjetëra vepra të mëdha në Itali. Madje, aktivitetin ajo e ka shtrirë edhe në Shqipëri edhe përmes një nënkompanie të saj, "INSO". Ndërkohë, më 3 maj të këtij viti qeveria shqiptare firmosi një kontratë me kompaninë "INSO" për ndërtimin e spitalit të ri 7-katësh në QSUT. Spitali i ri i sëmundjeve të brendshme e ka vlerën 14.4 milionë euro, ndërsa marrëveshja në atë kohë u nënshkrua mes ministres së Shëndetësisë, Ogerta Manastirliu dhe drejtorit ekzekutiv të kompanisë "INSO" Fabricio Pucarelli. Kjo marrëveshje me qeverinë shqiptare është pasqyruar edhe në faqen zyrtare të kompanisë italiane "INSO".



Konsullja shqiptare në Milano flet për gjendjen në Xhenova: S'raportohen viktima shqiptarë

Ndërkohë që vazhdon gjendja alarmante në qytetin e Xhenovës, ku ditën e djeshme ndodhi tragjedia e shembjes së urës së Morandit, ende nuk janë shpallur emrat e të gjithë personave të zhdukur, që kanë humbur jetën apo që janë plagosur. Ndërkohë që mendohet se në tragjedi të jenë përfshirë edhe dy shqiptarë. E kontaktuar për "Gazeta Shqiptare", konsullja shqiptare në Milano, Anila Pojani është shprehur se ende nuk ka një njoftim të saktë lidhur me përfshirjen ose jo të shqiptarëve në tragjedi.

A ka shqiptarë të përfshirë në tragjedi?

Ende nuk ka një



përgjigje lidhur me këtë gjë. Kemi lënë në dispozicion numrat e emergjencës, duke i telefonuar çdo gjysmë ore për

t'u informuar lidhur me përfshirjen ose jo të shqiptarëve.

Keni komunikim me autoritetet përkatëse? Çfarë ju kanë komunikuar deri tani?

Normal që ka komunikim si me policinë, ashtu edhe me spitalet. Duke qenë se trupat e pajetë janë dërguar në morg, ende nuk janë bërë identifikimet e tyre sepse nuk kanë ende të plotë as listëprezencën e të pranishmëve në tragjedi. Autoritetet vendëse janë gjithmonë në "alert", duke u përpjekur të shpëtojnë personat e bllokuar nën urë si dhe të impenjuar në kërkim të atyre që raportohen të zhdukur.

tërmete. Pastaj nuk ka qenë aq e fortë era se do të kishte dëme në bregdet, gjë që nuk ka ndodhur.

A ka pasur lëkundje këto ditë të urës që paraprindin në një katastrofë të tillë? E parandjenin vendësit?

Jo. Nuk ka pasur asnjë fenomen që mund të paralajmëronte këtë katastrofë.

Ju ishit prezent në vendngjarje? Si mund t'i përshkruani momentet e shembjes dhe më vonë?

Është një ngjarje tragjike. Më e madhja në 100 vitet e fundit në infrastrukturën rrugore. E gjithë Xhenova akoma është në "blackout". Fjalët janë të pakta për ta përshkruar. Një tmerr i vërtetë. Thonë se janë dëgjuar ulërima njerëzish në momentin e shembjes. Shumë drejtues e pasagjerë akoma janë të bllokuar në segmentet e autostradës derisa të bëhet evakuimi i plotë i tyre.

Ardian Gjika: Më thanë shokët se po të digjet shtëpia, mendova se po bënin shaka

FIER

Një ditë pasi dogji banesën e bashkë jetuesit të saj dhe e la atë në qiell të hapur, policia e Fierit ka arrestuar 42-vjeçarën Rudina Kishta, banuese në fshatin Grecalli. Gruaja u vu në pranga, pasi dyshohet se ka tentuar të vrasë dy vajzat e saj binjake 6 vjeçe, duke tentuar t'i mbyste ato në ujërat e lumit Seman në afërsi të urës së fshatit Daullas në Fier. Mësohet se dy të miturat kanë mundur të shpëtojnë falë ndërhyrjes së peshkatarëve. Njëri prej tyre ka thënë në polici se kishte parë një grua që u zhyste kokën në ujë vajzave të vogla. Ndërkohë, banorët janë shprehur se janë shokuar nga kjo ngjarje. Pas arrestimit për zjarrvënje, 42-vjeçarja ka mohuar djeqjen e shtëpisë së bashkëjetuesit të saj, Ardian Gjika. Por, pas rimarrjes në pyetje, ajo ka pranuar autorësinë e ngjarjes si dhe tentativën e mbytjes së vajzave të saj, të cilat i kishte nga një martesë më e hershme. Me Ardian Gjikën kishin pak ditë që ishin ribashkuar pas një zënke të mëparshme. Mësohet se Rudina Kishta ka shfaqur shenja paqëndrueshmërie mendore dhe për këtë arsye hetuesit e çështjes kanë kërkuar ekzaminim mjekësor të saj. Ndërkaq, dy vajzat e saj janë marrë në mbrojtje dhe janë transferuar në një institucion kujdesi në kryeqytet. Materialet në ngarkim të nënës së dy femijëve i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier për veprat penale "Vrasja për shkak të rrethanave familjare" e mbetur në tentativë dhe "Shkatërrimi i pronës me zjarr". Ndërkaq, Ardian Gjika tregoi dje për "Gazeta Shqiptare" se si e mori vesh ngjarjen, ndërsa mendonte se shokët po bënin shaka kur i thanë se po i digjet shtëpia. 47-vjeçari tha se gruan me të cilën nuk kishte bërë celebrim e kishte marrë dy net

1 dogji shtëpinë burrit dhe tentoi të mbyste 2 vajzat e binjake, arrestohet 42-vjeçarja

Dëshmitarët: Gruaja ua kishte zhjytur kokën në ujërat e lumit Seman të miturave



Ardian Gjika duke folur për "GSH"



Shtëpia e djequr nga 42-vjeçarja

më parë pas një ndarjeje disamujore. Sipas tij, kishte qenë vetë gruaja që i kishte thënë që do kthehej në shtëpi. **Zoti Ardian, ku ishit në momentin që banesa kishte marrë flakë?** Në fshatin Daullas, po takoja një shok. Ajo zonja bëri tentativë për ta djequr njëherë. E kisha nxjerrë përjashta, nuk e di ku vajti e po kthehej. Aty tek kthesa e pashë dhe i thashë që ik se është shtëpia hapur. Sa

mora kafënë, më thanë shokët shiko se po të digjet shtëpia. E mora për shaka, kur shikoj unë, shtëpia e djequr. **Di gjë se pse ia ka vënë flakën shtëpisë suaj?** Bën vaki do ketë qenë me depresion, kushedi. Se ajo më tha mua dua të iki tek nëna. Mbrëmë erdhi, pruri gjithë atë plaçkë, një kamion. I thashë mbaro punët se do të të çoj në darkë. Ajo i ka vënë flakën. **Ju e kishit marrë këto**

ditë gruan në banesë? Dje (të hënë) sa e mora në shtëpi. Kishte dy femijë të vegjël, nga 6 vjeç. **Ku ishin femijët?** Me të ishin rrugës. **Ishin në banesë me zotën?** Nga mbrëmë? Jo sot? **Nuk e di se isha në Daullas.** **Pse mendoni se ia ka vënë flakën?** Donte të ikte tek mamaja. I thashë mos u mërzi, në

darkë i thashë mbaroj punë, marr makinën e të çoj. Mirë tha ajo. **A ka tentuar më parë të djeqë shtëpinë?** Jo, jo. E pata 6 muaj më para, iku ndenji pak, më tha mua do vij. **Çfarë ju është dëmtuar në banesë?** Tejt e tej, ç'kisha, i gjithë malli. Me divane e me të gjitha. **Bashkëshortja si qe?** Rudina. Ia harrova mbemrin...

SHKURT

Sherr mes vëllezërve, njëri plagoset me thikë
TIRANË - Një sherr për motive të dobëta mes dy vëllezërve ka degjeneruar në përdorimin e armëve të ftohta dhe për pasojë është plagosur njëri prej tyre. Sipas policisë, ngjarja ka ndodhur mesditën e djeshme në rrugën "Meme Meto" të kryeqytetit. Mësohet se shtetasi me inicialet I.X. ka goditur në trup me mjet prerës, vëllain e tij A.X. I plagosuri është transportuar në spital për ndihmë mjekësore dhe ndodhet jashtë rreziut për jetën. Ndërkaq, blutë kanë kapur autorin e krimi.

Ekstradohet nga Greqia i dënuari me 8 vite burg

TIRANË - Ekstradohet nga Greqia një 29-vjeçar, i cili është dënuar me 8 vite burg për trafik prostitucioni. Burime zyrtare nga policia bënë dije se Viktor Floqi, 29 vjeç, lindur dhe banues në Elbasan, ishte shpallur në kërkim ndërkombëtar nga Z.Q.K Interpol Tirana më datë 17.11.2016, pasi Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, me vendimin penal nr. 63, datë 10.05.2016, e ka dënuar me 8 vjet burg për veprën penale të "Trafikimi i personave të rritur". Po të njëjtat burime pohuan se Viktor Floqi më datë 7 qershor të vitit 2014 ka trafikuar me qëllim prostitucioni nga Shqipëria në Itali shtetasen J.H., banuese në lagjen "Partizani" në Elbasan.

Tërmeti në Mat, ushtria ngrë çadrat për të dëmtuarit

MAT - Tetë familjeve që iu dëmtuan banesat dhe u bënë të pabanueshme nga tërmeti i 11 gushtit, forcat e ushtrisë iu montuan çadrat pasditën e së hënës. Pasojat me të mëdha tërmeti i shkaktoi në njësinë administrative Derjan dhe Macukull në Bashkinë e Matit, duke lënë disa familje në qiell të hapur. Ndërkohë, grupet e ngritura nga bashkia për verifikimin dhe vlerësimin e dëmeve vijojnë punën në terren.

Shishnin kokainë në lokalet me muzikë tallava, përfundojnë në pranga 2 shpërndarësit nga Lezha

TIRANË - Policia e Tiranës ka finalizuar operacionin e koduar "Pazari i Mesnatës", duke vënë në pranga dy persona, të cilët akuzohen se shishnin kokainë në lokalet me muzikë tallava të kryeqytetit. Bëhet fjalë për shtetasit Agostin Zefi, 56 vjeç dhe Zef Bokaj, 30 vjeç, të dy banues në Lezhë. Sipas bluve, për dy personat e mësipërm disponohet informacion se në bashkëpunim me njëritjetrin merreshin me veprimtari të kundraligjshme në fushën e narkotikëve, duke shpërndarë lëndë të dyshuar narkotike në llojit kokainë në lokalet me muzikë dhe tallava, në zona të ndryshme të Tiranës. "Në saj të punës së mirorganizuar hetimore është bërë arrestimi i tyre në flagrancë, pasi në rrugën 'Kongresi i Manastirit', gjatë



Finalizohet operacioni antidrogë "Pazari i Mesnatës". Seku

kontrollit të ushtruar në mjete tip 'Audi', brenda të cilit ndodheshin këta shtetas u gjet një qese me lëndë të dyshuar narkotike të llojit kokainë. Në cilësinë e provës materiale janë sekuestruar 200 gr kokainë, automjetet tip 'Audi' dhe tip 'Renault' si dhe dy aparate celularë. Materia-

let procedurale do t'i kalojnë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, për veprime të mëtejshme hetimore për veprën penale të 'Prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike e kryer në bashkëpunim', thuhet në njoftimin zyrtar të policisë së Lezhës.

Ekzekutoi dy persona në '99-n, arrestohet 39-vjeçari i dënuar me 20 vite burg

PUKË - Efektivët blu të Pukës kanë arrestuar dje një 39-vjeçar pasi është dënuar për vrasje të dyfishtë. Ndue Memaj ishte i shpallur në kërkim për vrasjen e dy personave në vitin 1999, ndërsa ishte dënuar me 20 vite burg. Ai u kap nga blutë e Pukës në bashkëpunim me forcat Operacionale të Policisë Shkodër, në bazë të informacioneve të marra në rrugë operative. "39-vjeçari, banues në Lezhë, më datë 3 nëntor të vitit 1999 ka vrarë me armë zjarri shtetasit me inicialet J. N dhe A. H., dhe për këtë ngjarje Gjykata e Apelit Shkodër me vendim nr. 407 datë 07.11.2013 e ka dënuar me 20 vite burg për veprat penale 'Vrasja me paramendim' e 'Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit', thuhet në njoftimin zyrtar të policisë. Ndue Memaj ka vrarë për gjakmarrje në vitin 1999 shtetasin Jak Ndoka, i cili po drejtohte një automjet furgon në Fushë-Arrëz kur u qëllua për vdekje nga i arrestuari. Furgoni doli nga rruga dhe u përplas me një kioskë aty pranë, brenda së cilës ndodhej shitësi Agron Hyseni, i cili për pasojë humbi jetën në vend.



KAMËZ - Biznesi i një familjeje në Kamëz është sulmuar me armë zjarri dhe me eksploziv. Mësohet se ngjarja e rëndë ndodhi në orët e para të mëngjesit të djeshëm në lokalin "Kaslin" në pronësi të Shkëlqim Halilit, i pozicionuar në rrugën "Bulevardin Blu" rreth 500 m poshtë Bashkisë Kamëz. Sipas burimeve zyrtare nga policia, rreth orës 02:07, në



Atentati, autorët djegin makinën në Fushë-Krujë

Sulmohet me armë zjarri dhe eksploziv lokal dhe banesa e familjes Halili në Kamëz

oborrin e banesës së shtetasit Sh.H., është hedhur një sasi lënde plasëse, e cila ka shpërthyer duke shkaktuar vetëm dëme materiale në dy mjetet e parkuara në oborrin e banesës. Gjithashtu, autorët e krimit kanë qëllu-

ar me armë zjarri në drejtim të banesës. Grupi hetimor po punon për zbardhjen e plotë të rrethanave të ngjarjes, identifikimin dhe kapjen e autorit/ve. Ndërkaq, mësohet se pak orë pas ngjarjes në Kamëz ku u qëllua me

armë lokal në katin e parë të banesës dhe më pas shpërtheu një sasi eksplozivi, policia ka gjetur në Fushë-Krujë një makinë tip furistradë të djegur dhe brenda saj dy kallashnikovë. Dyshohet që armët që u gjetën

në automjetin në fjalë janë përdorur nga autorët në ngjarjen e ndodhur në Kamëz. Burimet e mësipërme sqaruan se janë sekuestruar pamjet e kamerave të sigurisë që kanë kapur momentin kur autorët kanë qëlluar me breshëri drejt lokalit dhe banesës. Ngjarja mund të kishte përfunduar në tragjedi, pasi brenda objektit kanë qenë të pranishëm të gjithë anëtarët e familjes Halili, mes tyre gra dhe fëmijë.

Humbi të bijën 7 vjeçe, Ferit Ndreu: Vajza tjetër s'ngrihet dot në këmbë

Dorjana Bezat
TIRANË

Aksidenti tragjik në Kamëz, nëna: Akoma nuk më besohet se nuk e kam njerën vajzë

Valbona Ndreu: I kisha përdore dhe po shikoja rrugën kur u goditëm nga pas"

Valbona Ndreu së bashku me dy vogëlushet e saj doli nga shtëpia mëngjesin e 8 gushtit, e shqetësuar për shëndetin e tyre, pasi ishin me temperaturë, por nuk e dinte se ky do të ishte udhëtimi i fundit që ajo do të bënte me të dyja vajzat së bashku. Një makinë i përplasi në rrugë, duke i marrë jetën vajzës së madhe dhe duke shkakuar probleme të rënda shëndetësore tek ajo dhe vajza e vogël. Pak ditë pas aksidentit tragjik ku humbi jetën vajza 7-vjeçare e familjes Ndreu dhe një 29-vjeçar, Valbona ka folur për herë të parë për "News 24" në lidhje me këtë ngjarje.

DËSHMIA E NËNËS

"Atë ditë unë kam qenë me vajzat te spitali, me bashkëshortin. Besoj që e kam parë rrugën dhe kam ndalë në trafikndarësen. Në momentin që po shikoja për të kaluar rrugën në anën tjetër, kam pasur dy vajzat përdore. Nuk di asgjë, e di që kam pasur si një tërmet nga mbrapa edhe më pas nuk di asgjë. Akoma s'më besohet. Që ta marrësh përdore e ta heqësh nga duart nuk më besohet. I mbaja gjithmonë përdore, akoma s'më besohet që s'e kam njerën vajzë", - tregoi mes lotësh Valbona nga shtirata i Spitalit të Traumës, ku dhe po merr ndihmën mjekësore së bashku me Elonën e vogël. Fatmirësisht aksidentit i shpëtoi djali i familjes, i cili vetëm një minutë para aksidentit tragjik ishte larguar me të atin. Për babanë e vajzave, kjo ishte një traumë. Ferit Ndreu pohoi se bashkëshortja dhe vajza e vogël kanë dëmtime serioze nga aksidenti.

BABAI I SË MITURËS

"Gjendja shëndetësore e vajzës është shumë e dobët. Ajo është shumë keq, pasi nuk mbahet në këmbë. Ka vatër të gjakut, ka dëmtime të trurit, ka dëmtime të kockave. Ajo ka bërë vetëm një ekzaminim dhe nuk ka një ekzaminim të dytë për të ditur se në çfarë situatë është vajza dhe në çfarë situatë është nusja", u shpreh Ferit Ndreu. Ai tha se pavarësisht gjendjes së tyre, mjekët kanë



Valbona Ndreu me vajzën e vogël në Spitalin e Traumës

sugjeruar që dy pacientet ta lënë spitalin. Ndreu u shpreh se jo vetëm gjendja fizike, por edhe ajo psikologjike është tepër e rëndur. "Fola me doktorin se si mund ta nxjerr nga spitali. Ajo anën psikologjike nuk e ka kaluar akoma. Më tha që nuk ka psikolog këtu. Ato kanë nevojë për regjim

spitalor, jo për regjim krevati në shtëpi", deklaroi Ferit Ndreu. Kjo situatë e bën Feritin të mendojë se e gjithë kjo bëhet për të favorizuar shkaktoreshën e këtij aksidenti, 38-vjeçaren Rozina Koleci, e cila momentalisht ndodhet nën masën e sigurisë "Arrest me burg". "Dikush po



Ferit Ndreu duke folur për "GSH"

ndërhyn, apo po bën ndonjë veprim jo të duhur që nusja dhe vajza të dalin nga spitali, mbase edhe për të lehtësuar dikë tjetër", tha ai. Ndërkaq, "News 24" kontaktoi mjekët e Spitalit të Traumës, të cilët shpjeguan se për dy pacientet janë zbatuar të gjitha protokollet

mjekësore. Gruaja është mbajtur në spital vetëm që të ishte pranë vajzës, ndërsa për këtë të fundit janë bërë të gjitha trajtimet që spitali ka për detyrë. Burime nga spitali thanë se mjekët janë të gatshëm të përgjigjen edhe ligjërisht për veprimet e tyre mjekësore.

AKSIDENTI

Në aksidentin tragjik të 8 gushtit humbën jetën 29-vjeçari Ramazan Isha, i cili po lëvizte me biçikletë si dhe vajza 7-vjeçare e çiftit Ndreu. Ngjarja u shënuar tek shinat e trenit. 38-vjeçarja Rozina Koleci, e cila drejtonte makinën me targë AA071UA, fillimisht përplasi për vdekje shtetasin Ramazan Isha, i cili ishte duke drejtuar biçikletën. Më pas përplasi edhe 29-vjeçaren Valbona Ndreu me dy vajzat e saj që po kalonin në anën tjetër të rrugës.

Komisioneri Publik kundër KPK, ankimon vendimin për gjyqtaren Alma Brati

TIRANË - Komisioneri Publik ka ankimuar në Kolegjin e Posaçëm të Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese, vendimin nr. 32, të datës 5 korrik të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit Alma Brati, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe kandidatë për anëtare e Këshillit të Lartë Gjyqësor: Në vlerësimin e Komisionerit Publik, në rastin

konkret, hetimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nuk është i plotë. Për rrjedhojë, faktet dhe provat e administruara në përfundim të këtij hetimi administrativ janë të pamjaftueshme për të mbështetur vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, referuar pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Repub-

likën e Shqipërisë". Bazuar në përmbajtjen e pikës 3, të nenit F, të aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Komisioneri Publik nëpërmjet këtij ankimi kërkon nga Kolegji i Posaçëm i Apelit që këto mangësi të hetimit administrativ të kryera nga Komisioni i Pavarur të Kualifikimit të mund të riparohen nga Kolegji gjatë shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore. Mbështetur në pikën 1, të nenit 16, të rregullores së



Institucionit të Komisionerëve Publikë, ankimi është publikuar në faqen zyrtare të këtij institucioni. Komisionerët Publikë kanë pasur edhe rekomandim nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit (ONM).

cio dhe për një ankim, në rastin e subjektit të rivlerësimit, z. Bashkim Dedja, Komisionerët Publikë kanë pasur edhe rekomandim nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit (ONM).

MINISTRJA E MBROJTJES INTERVISTA

Ministrja e Mbrojtjes rrëfen për herë të parë për familjen: Për çfarë e çmoj bashkëshortin

Olta Xhaçka: Çfarë më vë në siklet para ushtarakëve

"Baza në Kuçovë, NATO vlerësoi rolin e Shqipërisë"

Ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka ka rrëfyer në një bisedë për emisionin "Pushime On Top" në "Top Channel", sfidat e saj si ministre, përjetimin e disiplinës në një ministri të fortë, siç është Mbrojtja. Teksa ka marrë disa ditë pushimesh në Shtëpinë e Pushimeve të ushtarakëve në Jalë, Xhaçka ka folur për herë të parë për familjen, vajzën e saj Hana dhe bashkëshortin, ish-deputetin socialist Artan Gaçi.

Zonja ministre, si ndodhi që gjete pak kohë për të pushuar?

Ndodhi që kryeministri i dha kabinetit qeveritar dy javë leje. Sigurisht që nuk kanë qenë javë të plota lejeje dhe realisht nuk është se pushohet me kohë të plotë, pasi puna sido që të jetë mbarët pak edhe gjatë ditëve të pushimeve. Megjithatë, ka qenë një periudhë relaksuese këto 3-4 ditë që kam qenë këtu, një periudhë e kaluar me time bijë, që ma ka bërë edhe më të këndshme, edhe më të bukur. Sigurisht pushimet të tilla janë, por fakti që pas një viti po kaloj një kohë shumë më cilësore dhe dedikuar për të është një kënaqësi shumë e madhe për mua.

Zgjedhët Jalën, për shkak se edhe kryeministri tha se të gjithë ministrat duhet të pushojnë në Shqipëri, apo ishte edhe dëshira juaj?

Është pa diskutim dëshira ime. Është Shtëpia e Pushimit e ushtarakëve. Këtu pushojnë stafi i Ministrisë së Mbrojtjes dhe stafi i Shtabit të Përgjithshëm. Është një ambient shumë i bukur, që i ofron të gjitha kushtet për të bërë pushime shumë të bukura dhe nuk ka asgjë më pak se sa ambientet e tjera jashtë vendit apo diku tjetër. Kështu që është pa diskutim zgjedhja ime. Është edhe një politikë e qeverisë për të promovuar turizmin dhe për të shpenzuar sa më shumë kohë në këto vende të mrekullueshme që Shqipëria ofron për të pushuar.

A nuk është pak e lodhshme që edhe në punë keni



Ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka

të njëjtin staf, edhe me pushime keni po ata? Ndoshta duhet ndonjëherë ndonjë shkëputje nga njerëzit e punës...

I takon ose i shikon në një mënyrë tjetër. Nëse më përpara jemi parë të kollarisuar dhe duke diskutuar për punë, tani është pak më ndryshe, sepse takohesh në një ambient shumë më të relaksuar edhe për të konsumuar një bisedë apo kafe miqësore përtej atyre kornizave profesionale, që ndonjëherë të dikton zyra apo ambientet shumë serioze të Ministrisë së Mbrojtjes. Është për mua një mundësi shumë e mirë edhe për t'i takuar njerëzit në pjesën tjetër më familjare.

Në fakt është hera e parë që na jepet mundësia që të kemi ministrin e Mbrojtjes në aspektin familjar, tekta pushon e zhveshur nga detyra. Si ka qenë për ju eksperiencë në ministri, një ambient kryesisht me meshkuj?

Për mua për hir të së vërtetës ka qenë një eksperiencë shumë e bukur. Kam mësuar ta dua shumë këtë punë që bëj dhe këtë institucion që drejtoj. Nuk mund të them se e kam njohur shumë

më përpara, sepse puna apo kontributi im në politikë dhe formimi im më kanë orientuar në të tjera gjëra, që s'kanë qenë të lidhura me çështjet e sigurisë dhe të mbrojtjes. Por unë jam studente e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe Ministria e Mbrojtjes, pa diskutim ka edhe një komponent diplomatik të përfshirë në të. Është edhe një ministri, që për hir të së vërtetës nuk është fort e dukshme, ka kaq

MINISTRIA

Sipas Xhaçkës, ministria që ajo drejton, "është edhe një ministri, që për hir të së vërtetës nuk është fort e dukshme, por ka kaq shumë dimensione. Disa thonë që është një shtet brenda shtetit. Kështu që të jep mundësinë që të shikosh dhe të drejtosh në shumë aspekte e dimensione. Është një punë jashtëzakonisht e bukur".

BASHKËSHORTI

"Kam idenë që jemi njohur në rrethana të tilla që na kanë bërë sigurisht partnerë, bashkëshortë, por edhe miq realist shumë të mirë. Konsultohem gjithmonë me të. Nuk mund të them se vendimet tona janë gjithmonë të njëjta, por kemi një dialog shumë të shëndetshëm dhe shumë miqësor në prag të çdo sfide apo vendimmarrjeje", tha Xhaçka për bashkëshortin e saj, ish-deputetin socialist Artan Gaçi.

shumë dimensione. Disa thonë që është një shtet brenda shtetit. Kështu që të jep mundësinë që të shikosh dhe të drejtosh në shumë aspekte e dimensione. Është një punë jashtëzakonisht e bukur.

Ju keni qenë ministere edhe në Ministrinë e Çështjeve Sociale dhe kaluat në Ministrinë e Mbrojtjes. A ju duket se janë dy skaje të kundërta? Cila ishte vështrësia, pasi edhe profili juaj duket që është më social?

Ndoshta ekzaktesisht kjo mund të thuhet se ishte vështrësia e parë, pjesa që disiplinën e ushtrisë ose dukjen e pamjes së rreptë unë nuk e mishëroja në natyrën time, duke qenë pak më e ndjeshme, nëse mund të jetë kjo fjala siç e cilësuat ju. Por,



Ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka me bashkëshortin

nga ana tjetër kuptova që nuk është e nevojshme për të ndryshuar natyrën për të drejtuar institucionin. Unë sigurisht respektoj të gjitha rregullat e ushtrisë, linjën e komandimit, disiplinën, por kujdesem personalisht për gjithçka dhe gjithkënd që ka nevojë për vëmendjen e titullarit. Dhe në këtë kuptim bëj çmos që edhe ata që nuk do të ishin tradicionalisht në vëmendjen e ministrit, të jenë dhe le të themi kjo ndjeshmëri e imja është reflektuar kështu.

E vështirë të përshatëshit me një formë tjetër përshëndetjeje?

Do jem shumë e singertë me ju, ende më vë pak në siklet ajo përshëndetja. Megjithatë, është pjesë e punës, disiplinës së Forcave të Armatosura. Sigurisht e respektoj, por nga ana tjetër unë i përshëndes ashtu njerëzisht, siç kam bërë gjithmonë.

Tashmë ju jeni edhe nënë dhe dedikimi ndaj familjes, vajzës, besoj kjo i ka ndryshuar disi raportet

qoftë në përfshirjen politike, por edhe në detyrën si ministre...

Pa diskutim. Koha për të marrëdhënia me të është pa diskutim një sfidë për sa kohë që koha e lirë është e kufizuar, por është edhe merak kështu që kam sa i takon një impenjimi ndoshta pak më të madh timin në kohën e lirë për ta shpenzuar me të. Nuk kam aq kohë sa ç'do të doja të kisha, por atë kohë që ia dedikoj është tërësisht cilësore, që do të thotë jam 110 për qind me të, pas saj. Deri më tani, pavarësisht kufizimeve gjykoj që nuk e ka ndjerrë mungesën time cilësisht, pasi kam qenë gjithë kohën me të dhe pas saj, edhe kur nuk kam qenë aty fizikisht. Por ç'është më e rëndësishmja, dhe ky është një konstatim i imi për çdo grua në karrierë që për sa kohë që i dedikohen shumë cilësisht apo atë kohë që harxhojnë me fëmijët e tyre duke pasur një vëmendje të dedikuar, çdo gjë kompensohet.

Është vajza e babait, e përkëdhelur?

Është vajza e mamit totalisht. Babai është pakëz xheloz që ajo vazhdon të jetë ende goçë mami, sepse nuk e ka bërë ende atë kapërcimin. Do bëhet eventualisht goçë baba, se ka filluar të tregojë shenjat e para, por për momentin është ende goçë mami.

Për ministrin vetë si ka qenë? Keni qenë vajza e babit apo e mamasë?

Unë kam qenë vajza e babit më thënë të drejtën. Dhe e mbaj mend babin me shumë gjallëri kur kam qenë unë e vogël. Ma ka zburuar shumë fëmijërinë me vëmendjen që ka treguar dhe ndoshta është edhe një model se si unë dua të rris time bijë.





Zv.kryeministria takon zyrtarë të lartë të OSBE Senida Mesi: Reforma në drejtësi përshejton anëtarësimin në BE



Qeveria shqiptare është e angazhuar për të reformuar njëherë e përgjithmonë sistemin e drejtësisë, pasi vetëm një drejtësi e re do të mund të përforcojë demokratizimin, zhvillimin dhe përshejtojë anëtarësimin në BE", deklaroi dje zv.kryeministria Senida Mesi, gjatë një takimi me zyrtarë të lartë të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE), me të cilët diskutoi mbi proceset aktuale që prekin jo vetëm Shqipërinë, por edhe rajonin. Mark Pritchard, përfaqësues i Posaçëm i OSBE-së për Europën Juglindore, u interesua në mënyrë të veçantë për procesin e integritimit evropian të Shqipërisë dhe ecurinë e reformave thelbësore si ajo në drejtësi. Mesi konfirmoi angazhimin maksimal të qeverisë shqiptare për procesin e integritimit dhe realizimin me sukses të procesit parapërgatitor, që tashmë ka nisur me Komisionin Europian. Sa i takon reformën në drejtësi, Mesi u konfirmoi përfaqësuesve të lartë të OSBE-së se procesi i vetingut po ecën dhe ka

dhënë tashmë rezultatet e para, por natyrisht që duhet thelluar dhe përshejtuar në të ardhmen. "Ndërtimi i strukturave të tilla si SPAK apo Byroja Kombëtare e Hetimit janë hapa të tjera thelbësore që Shqipëria duhet të plotësojë deri në vendimin e qershorit 2019", u shpreh Mesi. Në kuadër të bashkëpunimit rajonal, Mesi u shpreh se Shqipëria është vlerësuar nga partnerët ndërkombëtarë për

rolin e saj konstruktiv në marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë në rajon dhe për kontributin e saj në stabilitetin e rajonit. Me besimin që vendet duhet të punojnë për një fqinjësi të mirë dhe produktive, Mesi shprehu gatishmëri dhe qeverisë shqiptare për të vazhduar rolin e vendit tonë si promovues i sigurisë dhe bashkëpunimit rajonal. Ajo nënvizoi gjithashtu se perspektiva e anëtarësimit në Bashkimin

Europian (BE) ka ndihmuar rajonin të tejkalojë konfliktet e së kaluarës dhe gradualisht të ndërtojë marrëdhënie të fqinjësisë së mirë. "Në sajë të proceseve të tilla si ai i Berlinit dhe iniciativave të tjera rajonale, tashmë kemi një rrjet të mirëfilltë të bashkëpunimeve multilaterale në rajon, çka i kanë sjellë edhe më afër vendet me njëra-tjetrën dhe ka përforcuar gjithëpërfshirjen", u shpreh Mesi. Në lidhje me Kosovën, Mesi u shpreh besimplotë për dialogun Kosovë-Serbi të drejtuar nga Bashkimi Europian dhe theksoi se propozimi i Komisionit Europian për liberalizimin e vizave është një lajm shumë i mirë për Kosovën dhe se vendi ynë mbetet në pritje të një vendimi pozitiv të Këshillit dhe Parlamentit Europian.

BAZA E NATO-s

"Është vendimi i Këshillit të Atlantikut të Veriut për ta kthyer Shqipërinë nga një vend anëtar në infrastrukturë të NATO-s dhe për ta kapërcyer ose për t'i shtuar standardit tonë me NATO-n këtë stad. Kjo është një gjë shumë pozitive, jo vetëm për komunitetin ku do të ngrihet, por për Kuçovën, përmes investimit që do të bëhet atje dhe të gjitha benefitet që vijnë nga investimet, por për të gjithë vendin", tha dje ministria Xhaçka.

Ndoshta mund ta kesh thënë gjatë jetës se nuk do të kish dashur që bashkëshorti të ishte pjesë e së njëjtës fushë, punë dhe për më tepër në politikë aty ku ke qenë aktive. Tashmë ke ndryshuar ky mendim, pasi Artani është bashkëshorti yt, jeni të dy në të njëjtën fushë dhe nuk e di sa jeni edhe partnerë në vendimarrje, në këshillim, në politikëbërje?

Kam idenë që jemi njohur në rrethana të tilla që na kanë bërë sigurisht partnerë, bashkëshortë, por edhe miq realisht shumë të mirë. Konsultohem gjithmonë me të. Nuk mund të them se vendimet tona janë gjithmonë të njëjta, por kemi një dialog shumë të shëndetshëm dhe shumë miqësor në prag të çdo sfide apo vendimarrjeje. Fakti që sot nuk është në politikë, paçka se është shumë i angazhuar në sensin e të qenit aktiv me aktualitetin, mbështetës për gjithë sa bëj unë dhe gjithë sa bën kjo qeveri dhe kjo mazhorancë, duke qenë se ka qenë edhe deputet i Partisë Socialiste, por sot më i dedikuar pranë familjes, një ndihmë shumë e madhe për Hanën, si edhe një mik e partner i pazëvendësueshëm për mua dhe për marrëdhënien tonë, të paktën kështu e ndiej unë.

Çfarë ka ai në pjesën politike që ju do t'ia kishit pak zilli?

Ka një intuitë që unë ia kam shumë zili. Ka një aftësi për të parë përtej asaj që duket...

Siç e do politika...

Siç e do politika, pa diskutim, por edhe për të qenë pak më largpamës, më vizionar, për çfarë duhet bërë për të mbërritur disa qëllime shumë të mëdha dhe shumë të mira, kuptohet për punën që ne bëjmë, për të zhvilluar vendin, për të ofruar një standard më të mirë jetese, për të përmirësuar cilësinë e jetës, që është puna e çdo qeverie dhe e çdo mazhorancë.

Do doja t'ju ngacmoja për një ngjarje të madhe që pritet, pikërisht për bazën ushtarake të Kuçovës, që është diskutuar mjaft dhe ka marrë vëmendjen e të gjithëve...

Jam shumë e sigur që ata që na ndjekin nuk duan të dëgjojnë shumë për bazën, por duan më shumë për detin dhe për plazhin. Megjithatë, dua t'ju them diçka që është shumë e rëndësishme dhe që mua më ka gëzuar si drejtuese e këtij institucioni pa masë. Është vendimi i Këshillit të Atlantikut të Veriut për ta kthyer Shqipërinë nga një vend anëtar në infrastrukturë të NATO-s dhe për ta kapërcyer ose për

t'i shtuar standardit tonë me NATO-n këtë stad. Kjo është një gjë shumë pozitive, jo vetëm për komunitetin ku do të ngrihet, por për Kuçovën, përmes investimit që do të bëhet atje dhe të gjitha benefitet që vijnë nga investimet, por kjo është një gjë pozitive për të gjithë vendin, për faktin se është një vlerësim nga ana e Aleancës për kontributin e Shqipërisë, për rolin e saj për sigurinë dhe për paqen, por edhe në projektimin e paqes përtej vendit tonë. Dua t'ju them që Shqipëria është sot një nga vendet që angazhohet më së shumti me kontributin e saj, me trupat e saj në të gjitha operacionet ndërkombëtare të Aleancës dhe ky është një fakt shumë i vlerësuar prej tyre. Shqipëria është një faktor stabiliteti

për të gjithë Ballkanin Perëndimor dhe sërish ky rol është vlerësuar në vendimin e tyre për të sjellë bazën.

Zonja Xhaçka, sa do të qëndroni për pushime? Do të kesh mundësi të rrish disa ditë të paktën të shijosh edhe Hanën?

Po shpresoj shumë. Kam marrë pushime deri në datën 15. I kam sytë nga parashikimi i motit, sepse jemi gjatë gjithë kohës edhe me emergjencat civile, me prefekturat, me bashkitë, për të marrë masat sa mund të marrim përpara që të mos kemi probleme me zjarret apo me këto që janë emergjencat sezonale. Fatmirësisht deri tani nuk kemi pasur dhe kjo po më lejon edhe mua të pushoj e qetë. Shpresoj të vazhdojmë kësh-

tu deri në fund. E shijoni detin të dyja? E ka qejf Hana?

E ka shumë qejf dhe unë e kam shumë qejf. E ka trashëguar nga mamaja...

Po, patjetër. Ditën që erdhët në Jalë kishit vajzën në krahë dhe po ecmi të bashkëshortin të tre qetë-qetë. Po a është e bezdisshme kur vijnë dhe ju takojnë njëzë dhe ju jeni me vajzën në krah, në rolin e nënës. Ishte një detaj që më tërhoqi vëmendjen? Sa e vështirë është?

Kam përshtypjen që edhe njerëzit janë të përmbajtur. E respektojnë privatësinë. Nuk do ta kisha problem, ndoshta se nuk ndodhë kaq shpesh, saç mund ta imagjinoni juve dhe nuk është se përberën ndonjë lajm që po

ecën një ministër tek Lungomare me bashkëshortin. Sigurisht ka njerëz që kur të njihin të përshëndesin, jo duke të ndërhyrë në qetësinë tënde familjare, por të përshëndesin. Po një pjesë e madhe edhe nuk të njihin, sepse nuk e mendojnë që mund të kalojë një ministër kreyt sportiv me një kapele me syze dhe ndoshta edhe nuk të njohin për hir të së vërtetës. Mua më bëri përshtypje. Imagjino që është ministre që mund të ngrejë shtetin në këmbë...

Edhe e mitizojnë pak figurën e ministrit, por natyrisht që jemi si gjithë të tjerët dhe jemi aty si gjithë të tjerët.

Ama diferenca bëhet, edhe teksa pushon duket sikur puna të shoqëron ashtu siç na the...

Fatkeqësisht po. Në mos në telefon, me mesazhe jam gjithmonë duke koordinuar një gjë, jam gjithmonë duke bërë një punë aq sa jo më larg se dje u ankova shëfës time të kabinetit se s'po më linte rehat dhe mund të merrte edhe disa vendime të vogla pa më thënë, por në fakt, sigurisht titullari duhet të jetë në dje.

Po Forcat e Armatosura marrin leje, çfarë ndodhë me ta?

Fatkeqësisht Emergjencat Civile janë të gjithë në gatishmëri. Kemi 6000 oficerë, 6000 efektivë të FA që janë sot në gatishmëri dhe nuk mund të marrin pushime derisa të kalojë ky sezoni i nxehtë që mund të na paraqesë edhe problematika, siç janë edhe zjarret. Duke alternuar dhe duke parë mundësinë që edhe puna të mos pengohet, edhe gatishmëria jonë si Forcë e Armatosur të mos cenohet, të kemi mundësinë që të alternojmë pushimet e njerëzve.



INVITATION TO BID

Swisscontact is an independent Swiss foundation promoting economic, social, and environmental development. Swisscontact's objective is to open up pathways out of poverty for people in developing countries through broad-based economic development. In its various projects Swisscontact facilitates access to skills development programmes, fosters competitive entrepreneurship, creates access to local financial services, and promotes sustainable use of resources.

In the framework of the Skills for Jobs project, Swisscontact seeks to realize the procurement object: "Purchase of electronic equipment and whiteboards", for the operation of Career Centers, the implementation of the School Management System, the application of combined learning and the improvement of IT infrastructure in partner schools.

Swisscontact, invites interested candidates to bid for the realization of the procurement object, according to the equipment list.

For more detailed information, please visit the following website:
<https://www.swisscontact.org/en/country/albania/our-office/jobs.html>

SITUATA E KRIMIT

INTERVISTA

Valentina Madani

Ish-drejtori i Policisë së Shtetit Ahmet Prençi paralajmëron se situata kriminale në Shqipëri është shumë delikate dhe e frikshme. Sipas tij është si një bombë që i është hequr siguresa dhe pritet të shpërthejë. Ish-kreu i policisë thotë për "Gazeta Shqiptare" se vullneti politik është instrumenti i vetëm i goditjes së krimit duke i shkëputur lidhjet me pushtetin. Ai flet për nevojën e aplikimit të ligjit antimafia, ndërsa zbardh arsyet se përse 'peshqit e mëdhenj' nuk hyjnë në rrjetë. Vetingun në polici, Ahmet Prençi e quan një proces të kotë që do na kushtojë 4 milionë euro pasi: "Elementi kriminal do të vazhdojë qetësisht veprimtarinë e tyre kriminale, do të rrisin pasuritë dhe paratë e tyre në këtë vend si gjatë dhe pas procesit të vetingut, nëse do të vazhdojë ky sistem qeverisës.

Realiteti është që, punonjësi i policisë është i monitoruar më shumë se askush tjetër në administratën e shtetit".

Z.Prençi si e konsideroni situatën e kriminalitetit në vend?

Vitet e fundit kemi konstatuar një fenomen të ri për sa i përket situatës kriminale në vend. Kjo konsiston pasi eksponentët e krimit të organizuar të cilët veprojnë në të gjithë vendin, tashmë kanë një pakt mes tyre dhe pushtetit për të vepruar së bashku duke koordinuar në përbashkëti dhe interesave të tyre të përbashkëta. E themë më qartë ata veprojnë në territoret e vendit të qetë e të pandalshëm në veprimtarinë e tyre, duke u pasuruar e duke forcuar hegemoninë në territoret ku veprojnë. Asnjë prej këtyre eksponentëve të njohur të krimit, në këto 6 vjet, nuk është cenuar nga strukturat ligj-zbatuese për të vetmen arsye: atë të aleancës së ngushtë të tyre me pushtetin dhe me qeverinë. Në momentin që do të prishet ky raport, ashtu sikurse pakti i qetësisë mes vetë grupeve kriminale, situata do të precipitohet dhe do përballemi me fenomene të rënda të krimit në Shqipëri. Vihet re që, orientimi i policisë është frenuar në dy obligime shumë të rëndësishme për momentin. E para, pas largimit të ministrit Tahiri nuk u bë një krehje dhe kontrolli i territorit për të sekuestruar të gjithë sasitë e magazinuar të lëndëve narkotike, asete këto të krimit të organizuar që trafikohen me tonelata herë pas here; e dyta, nuk shikojmë që të punohet nga policia për mijëra dosje të vjetra të pezulluara, gjë që do të sillte goditje të personazheve të krimit, të cilët tashmë janë të sigurt në vazhdimësinë e

Ish-kreu i policisë: Pas largimit të Tahirit nuk u bë krehje e territorit për sekuestrimin e drogës

Aferat kriminale, Prençi: Të amendohet ligji 'Antimafia'

"Arsyet pse 'peshqit e mëdhenj' nuk hyjnë në rrjetë"



Ish-drejtori i Policisë së Shtetit, Ahmet Prençi

veprimtarisë së tyre të mëtejshme. Unë mendoj që, policia e shtetit ka kapacitete të mjaftueshme për t'u angazhuar, mobilizuar e për të fituar betejën me krimin, por sot, ajo është e tulatur, e demotivuar, e spostuar nga misioni i saj, pikërisht sepse është nën trynysinë e pushtetit të mazhorancës dhe mungesës totale të vullnetit politik për të përbashkuar detyrimet e saj që i ngarkon ligji dhe Kushtetuta. Kemi me mijëra qytetarë të arrestuar për mos pagim energjie elektrike dhe për lyerje banesash pa leje ndërkohë që paradoksalisht, në 6 vjet nuk kemi të arrestuar asnjë personazh të njohur të krimit që ka kryer vepra të rënda kriminale si në të shkruarën apo dhe në të sotmen.

Këtë e konstaton çdo qytetar shqiptar në qytetin ku jeton, pasi të gjithë i njohin këta "baronë" që bëjnë ligjin në territore të caktuara, si me cv-në e tyre të pasur kriminale, po ashtu dhe me influencën politike që kanë me pushtetin për punësim, tenderë e gjithçka tjetër që lidhet me pasurimin dhe forcimin e zgjerimin e influencës së tyre. Situata kriminale në Shqipëri është shumë delikate dhe e frikshme. Është si një bombë që i është hequr siguresa dhe pritet të shpërthejë.

Çfarë po ndodh me

"Forcën e ligjit" dhe "vetingun" në polici?

Për mendimin tim, që të dyja këto përbëjnë boshtin propagandistik të qeverisë në vend. Është njëlljosi si sloganin i Tahirit me "Policinë që duam" që përfundimisht ishte një katastrofë për policinë, shoqërinë dhe integritimin. E ashtuqajtura "Forca e ligjit" është një mënyrë për të mbajtur popullin me shpërsë se: dikur e njëherë do veprojnë strukturat ligj-zbatuese. Ministri i Brendshëm bën evidencën e

PARALAJMËRIMI

"Situata kriminale në Shqipëri është shumë delikate dhe e frikshme. Është si një bombë që i është hequr siguresa dhe pritet të shpërthejë", - shprehet ish - drejtori i Policisë së Shtetit.

ANTIMAFIA

"Nuk ka qenë kurrë më i nevojshëm aplikimi i ligjit antimafia, më shumë se në këtë praktikë korruptive e kriminale siç janë PPP-të këtu, më shumë se në këto kushte aktuale, më shumë se në këtë moment jo pak kritik, në këto momente kritike ku po zhyet në moskund vendi", - tha z.Prençi.

pastër e nga ana tjetër realisht kemi një polici të tulatur duke pritur me ankh procesin e vetingut, totalisht e spostuar nga detyrimet e saj ligjore. Ndërkohë që në fund do konstatojmë se, me ligjin e vetingut do amnistohen drejtues policie që implementuan platformën qeverisëse të kanabizimit e trafikimit të lëndëve narkotike dhe procesi do jetë në fund një pastrim politik e klanor i organizatës së policisë. Elementi kriminal do të vazhdojë qetësisht veprimtarinë e tyre kriminale, do të rrisin pasuritë dhe paratë e tyre në këtë vend si gjatë dhe pas procesit të vetingut, nëse do të vazhdojë ky sistem qeverisës.

Realiteti është që, punonjësi i policisë është i monitoruar më shumë se askush

kontrollin e të gjithë strukturave të policisë në të gjithë vendin. Është për të ardhur keq që, ideatori dhe promotori i këtij ligji, Ministri i Brendshëm Fatmir Xhafaj, të kërkojë largimin nga policia të një punonjësi policie që mund të këtë takuar vëllain e ministrit, i certifikuar si trafikant droge... Kjo s'ka asnjë lloj sensi as në planin moral, as njerëzor, aspak ligjor!

Ambasadori Donald Lu ka kërkuar arrestimin e "peshqve të mëdhenj" por pse nuk po hyjnë dot në "rrjetë"?

Është folur e shkruar së mjafti për të ashtuquajturit "peshqit e mëdhenj"... Në lidhje me këtë mund të them se, për goditjen e krimit duhet vetëm një instrument, më

VETINGU NE POLICI

"Elementi kriminal do të vazhdojë qetësisht veprimtarinë e tyre kriminale, do të rrisin pasuritë dhe paratë e tyre në këtë vend si gjatë dhe pas procesit të vetingut, nëse do të vazhdojë ky sistem qeverisës. Prandaj vetingu është një proces i kotë, që do të na kushtojë rreth 4 milionë euro", - deklaroi z.Prençi.

dhetëra grupeve kriminale që sundojnë vendin, por nga ana tjetër, nuk ka asnjë reagim përveçse rezultateve të arritura nga goditjet e grupeve kriminale që shesin cigare rrugëve të Tiranës për bukën e gojës, që shesin një dorë preshe e specë për të blerë bukën e përditshme... Vetingu është një propagandë, me idenë se, pas pesë vitesh do kemi një polici të

tjetër në administratën e shtetit. Punonjësi i policisë monitorohet nga eprorët e çdo njësie policore, SHKACB, Drejtoria e Standardeve Profesionale, ILDKPKI, SHISH, Avokati i Popullit, publiku, media etj. Prandaj vetingu është një proces i kotë që do na kushtojë rreth 4 milionë euro, ndërkohë që ato që përmenda më sipër paguhen dhe kanë detyrim për të kryer

i rëndësishmi: vullneti politik!

Pikërisht, ky vullnet politik mungon! Ky është nyja që i ka lidhur duart, i ka mpaqur, atrofizuar institucionet ligj-zbatuese dhe ka çliruar dhe u ka dhënë forcë, siguri e garanci të gjithë eksponentëve të fuqishëm të krimit që veprojnë thuasje në të njëjtë vendin. Si mund të goditen kriminelët e këtij



vendi kur ato u përfshinë nga mazhoranca në parlament, në administratën e shtetit, në drejtimin e bashkive etj.? E si mundet të bien në rrjetë peshqit e mëdhenj duke pasur parasysh dhe fakt kokëfortë rastin Tahiri, ku kryeministri tregoi se është totalisht ai dhe vetëm ai mbrojtësi e njëkohësisht edhe problemi kryesor i avancimit të krimit në vend. Po t'i referohemi ambasadorit Lu, në Shqipëri ka me shumicë "peshq" të mëdhenj, por më i madhi prej tyre është vetë Kryeministri.

Kreu i PD-së Lulzim Basha ka deklaruar se me fillimin e shtatorit do prezantohet projekti i amendimit të ligjit antimafia që do të bëjë të mundur që çdo klient i qeverisë i përfshirë në skema korruptive PPP-sh do t'i nënshtrohet formatit dhe, le të themi, kontrolleve të ligjit antimafia. Si e konsideroni një nisim të tillë dhe a jeni pjesë e këtij projekti?

Kjo është një pyetje që do mundohem t'i përgjigjem teknikisht. PPP-të (Partneriteti Publik Privat), të cilat, tashmë janë damkosur nga FMN, BE, BB, e të tjerë organizma që mbikëqyrin dhe ndihmojnë ekonominë shqiptare, si një praktikë jo vetëm kundër interesit publik, por si një praktikë që po mbytet konkurrencën dhe kësaj ekonomisë e lirë. E themë ndryshe, përderisa interesi publik nuk përfiton, madje dëmtohet, domethënë që nga PPP-të përfitojnë ekskluzivisht persona privat, pa garë, përfitojnë personat që kanë "lidhjet e duhura në qeveri", duke shtuar kështu fitimet në kurriz të interesit publik.

Deri këtu jemi tek një praktikë haptazi korruptive por, nëse kësaj situatë i shtojmë faktin se, kjo qeveri tashmë është e njollshur pa kthim, e kapur disa herë në flagrancë me krimin e trafiket, rreziku kryesor i të ashtuquajturave PPP, është injektim përmes tyre në ekonomi i miliardave



Pelinku: 1 në 3 tenderë jepen pa garë, do rishikojmë ligjin për një konkurrencë të lirë

Koncesionet, PD: 70 mln euro klientëve të kryeministrit

"Sa miliona euro u shpenzuan për luks, makina, bileta avioni"

Valentina Madani

Demokratët akuzuan edhe kryeministrin Rama se në një vit i ka dhënë klientëve të tij 70 milionë euro para publike. Sipas selisë skema korruptive e ndjekur nga qeveria është përmes dhënies së 1 në 3 tenderë pa garë. Opozita shprehet se si pasojë e mungesës së konkurrencës janë shpenzuar për luks, makina, karburant e bileta avioni 229 milionë euro. Partia Demokratike paralajmëron se pas ardhjes në pushtet do rishikojë ligjin e koncesioneve e prokurimeve për konkurrencë të lirë dhe se me amendimet në ligjin antimafia do t'i rikthejë shqiptarëve çdo para të vjedhur. Drejtuesja e Departamentit të Antikorupsionit pranë PD, Lealba Pelinku, në një dalje për mediat deklaroi se 'Korrupsioni është në nivele alarmante ndërsa 1 në 3 tenderë'. Kontrolli i Lartë i Shtetit ka dalë me të njëjtin konkluzion si disa



Drejtuesja e Departamentit të Antikorupsionit pranë PD, Lealba Pelinku

institucione të rëndësishme ndërkombëtare. Departamenti Amerikan i Shtetit apo Gjykata Europiane e Auditit, se në Shqipëri nuk ka konkurrencë të hapur dhe 1 në 3 tenderë janë dhënë pa garë". U shpreh Pelinku. Sipas saj përkthimi në shifra i mungesës së konkurrencës në shpenzimin e parave publike, zbulon se qeveria e Edi Ramës i

ka dhënë klientëve të saj në 1 vit 70 milionë euro pa garë, duke rritur në mënyrë alarmante këtë procedurë korruptive në krahasim me vitin e parë të qeverisjes. Mënyra tjetër për të grabitur paratë publike është pjesëmarrja në tender e vetëm i kompanie. Edhe në këtë procedurë korruptive konkurrenca ka munguar plotësisht në 30% të rasteve,

duke paracaktuar fituesin e preferuar të qeverisë për ndarjen së bashku të miliona eurove të tjera nga taksat. - vijoi më tej ajo, duke theksuar se mungesa e konkurrencës ka sjellë që fondet publike të shpërdorohen pa kriter dhe, si në asnjë vend tjetër, të mos i kursehet asnjë qindarkë buxhetit të shtetit. Për Partinë Demokratike, shpenzimet e qeverisë janë marramendës. Ndërkohë që çdo ditë mbyllet 45 biznese, varfëria rritet dhe 133 mijë nxënës kanë braktisur shkollën, kampionët e babëzisë dhe korrupsionit kanë blerë 229 milionë euro makina, karburant, bileta avioni, fasada të mjerimit urban, pajisje për zyra e komoditete të tjera për luksin e tyre u shpreh Pelinku. Sipas saj rishikimi i ligjit të koncesioneve dhe prokurimeve për të siguruar konkurrencë të lirë, së bashku me ligjin antimafia, që do të kthejë tek shqiptarët ddot cent të vjedhur, do të jetë prioritet në luftën e PD-së kundër korrupsionit dhe kimit të organizuar.

të ardhura të drogës dhe organizatave kriminale, partnerë të kësaj qeverie. Me këtë kryeministër, minimalisht përmes lidhjeve kriminale të provuara të Saimir Tahirit dhe Fatmir Xhafajt ngërçi politik, vullneti, vizioni, e ardhmja mund të jenë me pasojë të pariparueshme. Nuk ka qenë kurrë më i nevojshëm aplikimi i ligjit antimafia, më shumë se në këtë praktikë korruptive e

krimiale, siç janë PPP-të këtu, më shumë se në këto kushte aktuale, më shumë se në këtë moment jo pak kritik, në këto momente kritike ku po zhyet në moskund vendi. "Nëse do të gjejsh lidhjet e kriminit, ndiq rrugën e parësë" do konkludonte Falkone. Në këtë kuptim, nuk kërkohen shpikje, opozita me të drejtë u referohet praktikave më të mira ndërkombëtare. Unë si një qytetar, për të

"Falimento i kompania, la 600 punonjës në rrugë"

Skandali në Portin e Durrësit, Berisha: Pas ngjarjes fshihet Balla dhe Agaçi

Ish-kryeministri Sali Berisha publikoi dje denoncimin e një qytetari dixhital "për lënien në mes të 4 rrugëve të 600 punonjësve". Sipas denoncimit punonjësit kanë ngelur pa punë tashmë pas falimentimit të një kompanie. Berisha shkruan se kompaninë EuroAsia, e inauguroi vetë kryeministri Edi Rama 18 muaj më parë. Po dje z.Berisha publikoi mesazhin e një qytetari dixhital, i cili tregon se pas këtij skandali fshihet kreu i grupit të PS-së Taulant Balla dhe Engjëlli Agaçi. Po ashtu denoncuesi shkruan se trageti ku ndodhi edhe përplasja mes udhëtarëve dhe punonjësve të sigurisë, mbështet si kompani nga Balla. "Taulant Toyota yaris dhe don Agaçi të lidhur me tragetin e skandalit të Portit të Durrësit! Lexoni denoncimin e qytetarit dixhital. "Doja t'ju informoja në lidhje me çfarë ka ndodhur në terminalin e pasagjerëve në portin e Durrësit, ngjarje e cila është e njohur dhe nga TV e ndryshme dhe që tregon gjendjen e sigurisë së qytetarëve shqiptarë e jo vetëm. Ngjarja ka ndodhur me datë 11.08.2018 në tragetin e kompanisë GNV. Kjo kompani me seli në Napoli është e suportuar nga deputeti socialist Taulant Balla. Duke pasur këtë suport dhe mbështetje e kapitenerisë të Tauland Alkës një abuzues me pushtetin, jo traget është jashtë kontrollit të sigurisë dhe në shumë raste ai transporton një numër pasagjerësh mbi kapacitetin transportues. Po ashtu të lidhur me këtë kompani është dhe don Engjëlli Agaçi dhe Arjan Laci. Ne pak fjalë linja e kompanisë GNV është e përfshirë e tërë në abuzim si financiar ashtu dhe në atë të sigurisë", thuhet në denoncimin e Berishës.

cilin shteti im ka investuar, falë dhe angazhimeve në detyra të ndryshme, kam eksperiencë dhe ekspertizë si shumë të tjerë, e ndjej detyrimin qytetar, njerëzor, për t'u angazhuar në çdo mënyrë e për të dhënë gjithçka mundem e kërkohet për të mirën e vendit tonë të përbashkët.

Opozita ka siguruar shqiptarët se një e ardhme e re po troket për ta, çlirimi i Shqipërisë nga krimi dhe çlirimi i zgjedhjeve nga shitblerja e votës. Si mund të arrihet një gjë e tillë?

Është emergjencë kombëtare në këtë situatë, që vendi të drejtohet nga njerëz me integritet, të vendosur në kraht të shoqërisë dhe popullit për rritjen e mirëqenies e të sigurisë dhe ballpërballë krimin dhe jo duke u bërë palë me të. Sot, pushteti dhe krimi janë një. Ndajnë favore e interesa ndërmjet tyre dhe kjo përbën mafian. Opozita e ka marrë përsipër këtë mision dhe për mua është një

'PESHQIT'

"E si mundet të bien në rrjetë 'peshqit e mëdhenj' duke patur parasysh dhe fakt kokëfortë rastin 'Tahir', ku kryeministri tregoi se është totalisht ai dhe vetëm ai mbrojtësi e njëkohsisht edhe problemi kryesor i avancimit të krimin në vend. Po t'i referohemi ambasadorit Lu, në Shqipëri ka me shumicë 'peshq' të mëdhenj, por më i madhi prej tyre është vetë kryeministri".

mision i vështirë, por historik dhe plotësisht i mundur.

Si mund të largohet karteli krim-politikë? A po përdoren lektë e kriminelëve për pushtetin?

Shoqëria shqiptare është në pikën e vlimit. Mund të them se, edhe socialistët e ndershëm që e kanë votuar dhe kanë kontributë politike për këtë mazhorancë, janë totalisht të zhgënjyer. E them këtë pasi, meritat dhe privilegjet e pushtetit po i shijojnë eksponentët të spikatur të krimin dhe jo funksionarët lokalë të partisë socialiste. Në këto kushte, ku

gjithçka kontrollohet e vendoset nga struktura kriminale, ku gjithçka po "zien" e po zhytet në krimë, mendoj që shoqëria duhet dhe do të reagojë fort për ta përbysur këtë gjendje. Nuk do hyjnë në punë as autoritizimi i pushtetit, as kërcënimet e strukturave kriminale që veprojnë në vend dhe as paratë e shumta të tyre. Populli nuk mund të vazhdojë pafundësisht të vuajë mjerimin e tij e të dëgjojë vetëm propagandën qeverisëse nga njëra anë, dhe hegjemoninë kriminale nga ana tjetër.

Si mund të shmanget blerja, dhunimi dhe tjetërsimi i votës nga paratë e

krimit dhe bandave kriminale?

Siç e theksuam dhe më lart, vetëm reagimi i fuqishëm i gjithë shoqërisë, i intelektualëve të këtij vendi, studentëve, profesorëve, të papunëve, duke mposhtur frikën dhe duke u përballur fuqishëm me kurajë e dënjitet më këtë oligarkë që mban vendin peng. Liria e ka një çmim. Sot, ajo është marrë peng nga një grusht njerëzish, të cilët do e pësojnë shumë keq kur t'iu ikë pushteti, t'iu sekuestrohen paratë e pronat e të jenë prapa hekurave të ligjit, dhe vetëm të ligjit. Zgjedhje të lira e të ndershme me blerje votash e kërcënimet kriminelësh nuk mund të ketë në këtë vend. Një qeveri jo e bërë palë me krimin mund të përgatisë vendin për zgjedhje normale. Është domosdoshmëri, është shpëtimtare për një vend që ëndërron Evropën, integritetin, prosperitetin...

NJOFTIM

"INTERLOGISTIC SH.P.K.", distributori i autorizuar për Shqipërinë i markave të kompanisë ndërkombëtare "JOH.WILH. VON EICKEN GMBH", njofton se cmimi i shitjes me pakicë për produktet DENIM RED 210 lëkë/Paketë, DENIM BLUE është 210 lëkë/Paketë dhe COMPLIMET BLUE është 230 lëkë/Paketë.

SHPALLJE ANKANDI

Datë 17.08.2018, Ora 16:00

Shoqëria Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tiranë. Tel. 404506426, Cel. 067 201 9460/ 068 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com. Shpall ankandin e parë për pasurinë e pajualjshme të debitorit Agron Shefqet Burhani dhe dorëzueses Hatize Shefqet Burhani: "Aparamenti barimi + Trua" me sipërfaqe 62 m2, nr. pasurisë 14/301, zona kadastrale 2574, e regjistruar në regjistrin hipotekor numër 2561 datë 07.10.1994, adresa: Lajçaj "15 Shtatori", pallati 53, shkalla 1, apartament 4, Tëpelëndi. Çmimi fillësar i ankandit të parë është në shumën 1280.000 (një milion e dyqind e tetëdhjetë mijë) lekë. Ankandit do t'zhvillohet në ambientet e Shoqërisë Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyra 107, Tiranë.

SHPALLJE ANKANDI

Datë 23.08.2018, Ora 16:00

Shoqëria Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tiranë. Tel. 404506426, Cel. 067 201 9460/ 068 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com. Shpall ankandin e dytë për pasurinë e pajualjshme të debitorit Enkelea Novaku dhe dorëzuesit Adriatik Novaku: "Trua" me sipërfaqe 100 m² dhe "Ndërtuesi" me 3 kate me sipërfaqe 90 m² secili, nr. i pasurisë 4/106, zona kadastrale 8581, vol. 13, faqe 69, adresa: Lajçaj Nr. 1, Pogradec. Çmimi fillësar i ankandit të dytë është në shumën 7280.000 (shtatë milionë e dyqind e tetëdhjetë mijë) lekë. Ankandit do t'zhvillohet në ambientet e Shoqërisë Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyra 107, Tiranë.

Përfituesit e këstit të dytë, dokumentet në Drejtorinë e Pagesave

Ornela Manjani

Ish-të përndjekurit, 470 trashëgimtarët marrin paratë

Ministria e Financave: Dorëzoni numrin e llogarisë dhe certifikatat

Rreth 470 fëmijët ish-të dënuarish politikë, trashëgimtarë të radhës së parë do të marrin dëmshpërblimin. Ministria e Financave ka publikuar listën e kategorisë jo përsore në radhët e ish-të përndjekurve politikë që mund të trajtohen me dëmshpërblim, por që sipas këtij dikasteri duhet të dorëzojnë dokumentet deri brenda 3 muajve. Ministria e Financave u kërkon përfituesve të këstit të dytë të dorëzojnë në drejtorinë e pagesave numrin e llogarisë për të marrë dëmshpërblimin. Lista me përfituesit, të cilët janë në radhë për këstin e tyre të dytë, duhet të përditësojnë numrin e llogarisë bankare

si dhe të dorëzojnë fotokopje të mjetit të identifikimit dhe çdo dokument tjetër që u mungon në dosje.

DOKUMENTET

Të gjithë trashëgimtarët e ish-të dënuarve duhet të sigurohen pranë bankës në të cilën kanë hapur llogarinë që llogaria e tyre është aktive. Në rast se llogaria nuk është aktive, shumica e dëmshpërblimit kthehet

mbrapsht në buxhet duke sjellë vonesa dhe ndërlikime të panevojshme. Kur kemi ndryshim të identitetit, Emër/Mbiemër, apo në rastet kur në certifikatë ndryshon emri ose mbiemri, qoftë edhe me një gërmë të vetme në krahasim me dëshminë e trashëgimit apo prokurës, kartës së identitetit dhe çdo dokumenti tjetër të nevojshëm, duhet medoem-

os që në të gjitha dokumentet emrat të jenë të njëjtë me atë që është shkruar në certifikatën e lëshuar nga gjendja civile. Në raste se ka transkriptime të gabuara gjatë kohës nga një certifikatë e një periudhe të caktuar, atëherë këto ndryshime duhet të pasqyrohen brenda formatit të certifikatës apo edhe të një vërtetimi të veçantë të lëshuar

nga zyra e gjendjes civile. Ligji parashikon edhe rastet e ekzekutimeve pa gjyq. "Në rastet e ekzekutimeve kapitale pa gjyq, është i domosdoshëm një vendim fakti gjykatë që vërteton vdekjen, plus një certifikatë negative të lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Në rastet kur për arsye të njohura në gjendjen civile nuk ekzistojnë dokumente të peri-

udhës përkatëse dhe ky fakt vërtetohet nga gjendja civile, i interesuari është i detyruar të bëjë një gjyq fakti, të cilin edhe në këtë rast si në pikën më lart, duhet ta shoqërojë me një certifikatë negative", thuhet në njoftimin që Ministria e Financave bën për të sqaruar trashëgimtarët e ish-të dënuarve që nuk kanë marrë ende dëmshpërblimin.

TRASHËGIMTARË PËR KËSTIN E DYTË

ZELIHE FETAH SEFAJ	ZENUN RUSTEM HOXHA	BRUNILDA ZEF PLAKAJ	MANJOLA AHMETIBRAHIMI
HAMIT HALIT SEFAJ	ARDJAN RUSTEM HOXHA	BLENDAR ZEF PLAKAJ	RONJET AHMET LAZRI
ALI HALIT SEFAJ	FATIME XHAFERR DEDEJ	LEONORA KEL VATA	MIMOZA AHMET DURICI
PIRO HAXHI BEDO	DILFIQARE XHAFERR	EMANUELA KEL VATA	BEDRIJE ISMAIL XHOLI
DONIKA HAXHI BEDO	UKU	ALFONS KEL VATA	BASHKIM ISMAIL LAZRI
SKENDER HAXHI BEDO	ILMI XHAFERR HOXHA	LILJANAROMANO MUSSAPI	LULZIME ISMAIL RAMA
DHURATA HAXHI LLESHI	TAFIL BEQIR DIGNOZI	CRISTOFANO ROMANO	HASIJE ISMAIL GAZI DEDE
SHQIPE HAXHI MARA	VEZIHANE BEQIR TUFJA	MUSSAPI	BARIJE ISMAIL CELA
THELLENZE HAXHI DELIALISI	SENTILJAN XHEVALIN	EUGENIO ROMANO	DESHIRE ISMAIL BALLIU
JERINA HAXHI BEDO	NDREU	MUSSAPI	LILJANA ISMAIL ILNICA
ARBEN HAXHI BEDO	MARKEL FRROK DODA	ERJON YZEIR BREGU	NAZIF ATIP XHOLI
ILIRA AGRON FONI	FRROK MARK DODA	LAURETA YZEIR BREGU	VASFI ATIP XHOLI
NERITAN AGRON DELIALISI	GJON MARK DODA	MIRELA YZEIR ALIAJ	ILIR ATIP XHOLI
MIDE ALI SPAHIU	MEROPI THEOFANI GJIKURIA	RUFAJETE ABAS METHOXHA	NAIM ATIP XHOLI
ARMAND HALIT SEFA	ANGJELI VASIL GJIKURIA	DALLENDYSHE ABAS KULAJ	RUZHDIJE NDRICIM
PASHKO DODE GJONAJ	HEKTOR VASIL GJIKURIA	MYNYR ABAS SHEHU	HOXHA
TONE PREL(PRENDE) GJELAJ	IBRAHIM HASAN HAXHIRAJ	NEXHMIE ABAS MUSARAJ	QEMAL NDRICIM HUNCI
PASHKO PREL(PRENDE) GJELAJ	NUREDIN HASAN HAXHIRAJ	PETRIT ABAS SHEHU	AGIM NDRICIM HUNCI
LULE PREL(PRENDE) MITAJ	RUKIE HASAN MUSARAJ	YQMET ABAS SHEHU	KADIFE NDRICIM BUZRA
GJELOSH PREL(PRENDE)	FIDAI HASAN HAXHIRAJ	FQIRETE ABAS LLANAJ	BUJAR NDRICIM HUNCI
GJENAJ	IBRAHIM HASAN HAXHIRAJ	NADIR ABAS SHEHU	AVNI NDRICIM HUNCI
MERKO KAMBER SHORAJ	PORTOKALLE FADIL RAMAJ	AGIM ABAS SHEHU	BEHAR NDRICIM HUNCI
HYDAI KAMBER SHORAJ	NIMETE FADIL HAZIZAJ	NIKO ABAS SHEHU	MANUSHAQE NDRICIM
GJERGJIKAMBER SHORAJ	VATHI FADIL XHELAJ	XHULJETA ABAS SHEHU	COTA
FLORETA KAMBER	PUSHIME FADIL CALA	USHTIMA ABAS SHEHU	ADRIAN NDRICIM HUNCI
LUZAJ	NORI FADIL HAXHIRAJ	XHEVAHIR ISUF FUSHA	ZEQIR MIFTARHUNCI
SUZANA KAMBER HADERI	ADELINA FADIL HAXHIRAJ	MEHMET ISUF FUSHA	HAKI MIFTARHUNCI
SHPETIME KAMBER LU-	MYZAFER FADIL HAXHIRAJ	DEDE NIKE HILI	HASAN MIFTARHUNCI
ARI	DESHIRA FADIL HOXHAJ	GJELOSH NIKE HILI	FARIJE MIFTARHUNCI
HIQMET KAMBER SHORAJ	MUHARREM SHABAN	KOLE NIKE HILI	MALIQ MIFTARHUNCI
VIRJON NEXHAT LAMAJ	HAXHIRAJ	PETRIT NIKE HILI	DAUT RAMADAN BARDHI
TEUTA NEXHAT YMERI	NOVRUZ SHABAN HAXHIRAJ	LIN NIKE HILI	ABDULLA RAMADAN
LUIZA NEXHAT XHERAHU	NAXHIE SHABAN ALIAJ	RESTEM HYSEN LIKA	BARDHI
SHEFIKATE NEXHAT	YSNIE SHABAN VEIZAJ	MYFTAR HYSEN LIKA	SHERIFE DESTAN ALBRAHIMI
MALAJ	ADRIATIK SHABAN	HAVA HYSEN ABDIJA	HASAN DESTAN ALBRAHIMI
EJELL RROK LLOGORI	HAXHIRAJ	ZEQINE ZENEL KAZHAJA	ILIR DESTAN ALBRAHIMI
VERA DODE ALIAJ	SHPETIM HAXHI HAXHIRAJ	HAZIS ZENEL LIKA	BEQIR DESTAN ALBRAHIMI
PJETER DODE ALIAJ	AFRIM BEQIR LALA	XHEMAL ZENEL LIKA	YRME TE ENVER KREKA
MARINA DODE ALIAJ	HELVETINE BEQIR AHMETAJ	ZENEL ZENEL LIKA	MUHAMET ENVER AGOLLI
PELLUMB IDRIZ HOXHA	BARDHOSHE BEQIR SHANI	KUSHE ZENEL KAZHAJA	JETMIRA ENVER KOLECI
YLLI IDRIZ HOXHA	DONIKA BEQIR HUSI	SHEFQET ZENEL LIKA	SHKELQIM MYZAFERAGOLLI
RUZHDIJE RUSTEM	ILJAS BEQIR LALA	MYZAFER AVNI LAZRI	MERITA MYZAFER ZHIVA
DINI	ERMIRA BEQIR NIKA	JETON AVNI LAZRI	LAVDERIM REXHEP
RESHIT RUSTEM HOXHA	NJAC GJON VATA	BLERINA AVNI RECI	HOXHA
JONUS RUSTEM HOXHA	LUIGJ GJON VATA	ADELINA AVNI CENGA	DEFRIM REXHEP HOXHA
MYFIT RUSTEM HOXHA	MARIJE GJON DABERDAKU	ADRIATIK FADIL LAZRI	KADRI REXHEP HOXHA
KASEM RUSTEM HOXHA	NIKOLIN ZEF PLAKAJ	IRMA FADIL VELAJ	ATMIRIM EMIN AGOLLI
LUF TAR RUSTEM HOXHA	MIRUSH ZEF PLAKAJ	ALFRED FADIL LAZRI	ENGJELUSHE EMIN MEKA
SHUAIP RUSTEM HOXHA	MONDI ZEF PLAKAJ	ELVANA AHMET DURICI	REFAT EMIN AGOLLI

SUELA MUHARREM BARKAJ	LLUKA KLEARKO GJKURIA	ZENEL YMER MERLIKA	MEXHIDE DYLE KETA
ARTEMIDA MUHARREM KO-	KATINA KLEARKO DUNI	BERAM YMER MERLIKA	MYFTAR ISMAIL KETA
CIRAJ	VASILIQIKLEARKO MUCO	TOMORRYMER MERLIKA	HYSEN ISMAIL KETA
ASTRIT DILAVER LAMKA	ZAHARULLA KLEARKO	BUJAR YMER MERLIKA	HIKE ISMAIL DISHA
SABRIJE SHEFQET HUQI	DUNI	ARIFE DERMISHA HOXHA	NAZMIE ISMAIL RAMI
DRITA SHEFQET ZELA	VASIL KLEARKO GJKURIA	SALI HAMET HOXHA	ALLTANE ISMAIL DEDOLLI
FTNET SHEFQET HOXHALLI	XHEMAL AHMET HAXHIRAJ	NEFERAT HAMETHOXHA	SHAJE TUG PIRI
RUKIJE SHEFQET METANI	HYSNIJE AHMET MAHILANJ	VANGJEL THOMA	ALI SHEFQET PIRI
KIMETE SHEFQET ZELKA	NEVRIE AHMET KAPAJ	FATIME HAMET DOLLANI	DILAVERHASAN LAMKA
ENEAL XHEMAL DISHA	YLMIA AHMET HAXHIRAJ	KADENE HAMET ZENELI	SHAQIBE MURAT GJOLEKA
HYSNI ABDI RAMI	FATIME AHMET CELAJ	RESMIJEBELUL LARAKU	AGIM MURAT GJOLEKA
LINDITA ABDI HYSI	FADIL AHMET HAXHIRAJ	RAHIM BELUL XHYRA	FATO MURAT BUSHI
ARJAN ABDI RAMI	MAMUDE MESUT HAXHIRAJ	BEHARE BELUL MERSINA	DRITA MURAT PROKO
SABIJE ABDI RAMI	HAXHI AHMET HAXHIRAJ	REXHEP QERIM SYLAJ	EMIN REFAT AGOLLI
ADEM SHEFQET DISHA	SADUSHE AHMETMERAJ	BAKI NEXHIPXHAF AJ	FISE REFAT HOXHA
XHEMAL SHEFQET DISHA	SHABAN AHMET HAXHIRAJ	HYSEN NEXHIPXHAF AJ	ZARIFE REFAT KUTROLLI
KUJTIM HYSEN KETA	MAZIJE AQIF NANI	SKENDER NEXHIP	MYZAFER REFAT AGOLLI
ADHURIM HYSEN KETA	SELMAN HYSENAGOLLI	XHAF AJ	ENVER REFAT AGOLLI
FLORIDAHYSEN MUCA	RUKIJE HYSEN KACANI	MRIKA LLESH MARKU	BARDHYLE REFAT SHURDHO
BESNIK MYFTAR KETA	AHMEDIE SULEJMAN	RUTA MARK GJOKA	FAHRIE SALI ALBRAHIMI
ISMAIL MYFTAR KETA	DACI	LULE PETRASH MIRASHI	HAVA SALI BARDHI
TUSHE MYFTAR KADIU	HASAN AHMET HAXHIRAJ	ROMINA ALEKSANDER MIRASHI	SELVIJE SALI HASA
AGIM MYFTAR KETA	SALO SHAHIN MIRACI	TUSHE AHMET LALA	NURIJE SALI DUSHKU
AVNI MYFTAR KETA	OSMAN AQIF MIRACI	XHEMALIJE QAMIL ISMAILI	TAHIR SALI BORUFI
RUKIJE ABDYL UKA	FATIME AQIF CEPE	ZOJE QAMIL DERVISHI	KADIFE SALI DOSKU
GJYLFI SHAHE ABDYL GJORLLAKU	HANUSHE AQIF LALA	EMINE QAMIL AZUNI	FARIJE IBRAHIM HUNCI
XHEMILE ABDYL SHEHI	ZARIJE IMER TONUZI	HYSEN QAMIL LALA	MIFTAR ZEQR HUNCI
KUJTIME ABDYL SHEHU	BUKURIE NJAZI LITA	HATIXHE QAMIL PUKA	BUKURIE ZEQR HUNCI
FLORINE ABDYL AHMATI	ZAHIDE NJAZI CAMI	IBRAHIM RAMADAN(DAN)	TUSHE ZEQR BUZRA
HAJREDIN ABDYL AHMATI	NJAZI NJAZI TONUZI	DODA	NDRICIM ZEQR HUNCI
SAFIDIJE ABDYL NDREU	SELMAN HYSENAGOLLI	SANIJE RAMADAN(DAN)	PEME ZEQR ALLA
AJET ABDYL AHMATI	ZARIJE IMER TONUZI	DODA	ZARE ABDULLA LAZRI
NURISH ABDYL AHMATI	BUKURIE NJAZI LITA	FITNETE RAMADAN(DAN)	NADIRE DALIP XHOLI
GJIN GEG LEKGEGAJ	ZAHIDE NJAZI CAMI	DODA	ISMAIL DALIP LAZRI
LLESH GEG LEKGEGAJ	NJAZI NJAZI TONUZI	FARIJE RAMADAN(DAN)	AHMET DALIP LAZRI
MARIJE GEG PERTENA	KOSTANDO NIKOLLA	LIKA	NEKI DALIP LAZRI
PRENE GEG KURTI	NIKA	GANI RAMADAN(DAN)	FADIL DALIP LAZRI
DILE GEG GJONAJ	KOCO MITRO NIKA	DODA	AVNI DALIP LAZRI
FRENCIS ROBERT FRASHERI	JANI MITRO NIKA	BUKURIJE RAMADAN(DAN)	MYZEJENE DALIP KROSI
DANIEL ROBERT FRASHERI	AMALIA MITRO COLLAKU	DODA	MEREME IBRAHIM
STELA ROBERT FRASHERI	LEFTERIA MITRO APOSTOLI	HAZIS RAMADAN(DAN)	LIKA
RAMIZ DAUT DAUTI	JEORGJICA LLAZAR	DODA	RAMAZAN ZENEL LIKA
NAXHIE DAUT NOKA	LAZO	QAZIM HAZIS NDREU	HYSEN ZENEL LIKA
SAKIP DAUT DAUTI	KRISTO THEODHORI LAZO	HUZRIE HAZIS NEZHA	EVANTHI VANGJEL
MUSTAFA DAUT DAUTI	ALEKSANDER THEODHORI	ABDI HAZIS NDREU	KATI
FIQIRETE DAUT KOLTRAKA	LAZO	FADIL ALI MUKJA	VASIL SPIRO NIKOLLA
MARINAQI LAVAR CULLAJ	VANGJEL THEODHORI	HANIFE ALI ALCANI	ALEKS SPIRO NIKOLLA
EVALAVER KALO	LAZO	LIZE LUIGJ GJINAJ	KRISTINA SPIRO SELISHTA
ANILA LAVAR CULLAJ	KLEONIDHI THEODHORI	PALINE LUIGJ NDOCAJ	KOSTANDIN SPIRO NIKOLLA
JAKPJETER NDRECA	FOTO	LENE LUIGJ GJINAJ	LULASH VAC HILI
ARSHI ABDI NDREU	IFIGJENIA THEODHORI	LULE LUIGJ LACA	NIKE VAC HILI
KADIFE ABDI HOXHA	LILI	MRIKE LUIGJ GJINAJ	SAIT SELIM FUSHA
ALLTANE ABDI HOXHA	TREZE GJEK LUCA	TONIN LUIGJ GJURAJ	FIFE MEHO FUSHA
HAZIS QAZIM NDREU	LUIGJ GJEK MIRI	TAHIR FEHIM MALELLARI	MUHAMET SAIT FUSHA
BEHIXHE HASAN MAMICA	TOME NIKOLL KOCI	MYFTAR FEHIM MALELLARI	GJYLJE SAIT FUSHA
SILVA CELIKA	NDUE NIKOLL KOCI	KADRI FEHIM MALELLARI	ISUF SAIT FUSHA
PETRIT ISUF LLOZHI	HAJRIE BESHIR ALLA	HAMDIE FEHIM MALELLARI	ABAS MYNYR SHEHU
MARIJE PREK GJELAJ	AISHE HAMIT KULLAFI	DILE PRENUSH NIKA	HAMDI MYNYR SHEHU
SPIRO KAMBER MUCAJ	AHMET HAMIT ALLA	LENE PAL NIKA	BEXHET MYNYR SHEHU
REFIJE KAMBER SHORAJ	XHANE HAMIT BARDHI	DILE PRENUSH NIKA	ENGJELLUSHE MYNYRDERVISHI
MIROSHI KAMBER	NEXHMIJE HAMIT LALA	LENE PAL NIKA	GJINOVEFA MYNYRBREGU
ALIAJ	MEREME HAMIT BALLA	PAL BARDHOSH PRENDI	LEONIDHA MYNYRSHEKA
NURE KAMBER LAMAJ	HANIFE HAMIT SINA	DILE BARDHOSH NDRECA	DRANDE GJELOSH GURI
TONE FRAN ALIAJ	XHELIL DEMO SADIKAJ	LAVAR ALI CULLAJ	ZOJE DED PROGNI
DRANE FRAN ALIAJ	ISMET DEMO SADIKAJ	MEHMET ALI CULLAJ	LEZE DED RAJA
GJYSTE FRAN ALIAJ	BEJKUSH DEMO SADIKAJ	ISMAIL ALI CULLAJ	MARI DED PERPANAJ
DIELLA FRAN SMAJLIAJ	ALI MUSA BRAHO	DAUT HAMIT DAUTI	NDREKE DED GURI
LENA FRAN LLOGORI	SHEMO MUSA BRAHO	PETRINA DHIMITER	LULE DED STAVRO
DODE FRAN ALIAJ	NEKI MUSA BRAHO	FRASHERI	LIN DED GURI
SELIME KASEM MUCA	LIRIMUSA EMINI	MARK GEG LEKGEGAJ	MHILL DED GURI
BESIM KASEM HOXHA	SOFIE MUSA BENDO	HAVA NEZIR LITA	LUCE VATE MUSAI
IDRIZ KASEM HOXHA	FATIME MUSA AGOLLI	HATIXHE ZENEL AHMATI	LORENC VATE GJELOSHI
ZEGJINEKASEM DIGNOZI	QERIM MUSA BRAHO	ELEZ ZENEL LITA	KEL VATE VATA
XHAFERR KASEM HOXHA	MUHAMET MUSA BRAHO	SAHIT ZENEL LITA	LIZE(LEZE) VATE PLAKAJ
RUSTEM KASEM HOXHA	LLUKAN SPIRO CICOLLI	HYSNI ZENEL LITA	GJON VATE GJELOSHI
PRENE LLESH LLESHI	ANDREA SPIRO CICOLLI	RRUZHDI ZENEL LITA	
DILA LLESH LLESHI	MIHAL SPIRO CICOLLI	MINE ZENEL LITA	
HARILLAOS KLEARKO	MARINA SPIRO PROKO	FILXHARIJE ZENEL LITA	
GJKURIA	DUHIJE YMER KUQI	ALI ZENEL LITA	

Fletorja Zyrtare/ Dokumentacioni që duhet dorëzuar. Brenda një muaji merrni përgjigjen



Voltiza Duro

Udhëzimi, subjektet që përfitojnë statusin e ndërmarrjes sociale

Shpallen kriteret ekonomike e sociale që duhen plotësuar

Të gjitha ato subjekte që dëshirojnë të marrin statusin e ndërmarrjes sociale duhet të plotësojnë kriteret dhe të dorëzojnë dokumentacionin, sipas udhëzimit më të fundit të publikuar në Fletoren Zyrtare nga Ministria e Shëndetësisë. "Procedura e marrjes së statusit inicohet nga vetë organizata jofitimprurëse me anë të një kërkesë drejtuar ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale. Kërkesa duhet të jetë në formë të shkruar dhe duhet të përmbajë edhe një përkrahim të shkurtër të veprimtarisë së organizatës dhe parashtrim të arsyeve se si organizata përmbush kriteret ekonomike dhe sociale të parashikuara në ligj për ndërmarrjet sociale", nënvizohet në udhëzim.

LICENCA

Në rastet kur një ndërmarrje sociale ushtron veprimtari për të cilat nevojitet licencë, pajisja me licencë, sipas përcaktimeve ligjore që rregullojnë licencimin, duhet të sigurohet përpara aplikimit për marrjen e statusit.



Faksimile e udhëzimit të publikuar në Fletoren Zyrtare

për vendimin e njohjes apo refuzimit të statusit, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e paraqitjes së kërkesës. Ndërkaq, në rast të përmbushjes së kriterëve ligjore, njohja e statusit bëhet me urdhër të ministrit, kurse në rast të refuzimit të statusit, njoftimi duhet të përmbajë edhe arsyet e refuzimit. "Në rast të njohjes së statusit, organizata jofitimprurëse detyro-

het të përdorë emërtimin "Ndërmarrje Sociale" përkrah emrit të organizatës. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Politikave

dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për zbatimin e këtij udhëzimi. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë pas botimit në

Viti 2018 – Numri 121

UDHËZIM
Nr. 602, datë 1.8.2018

PËR PROCEDURAT DHE
DOKUMENTACIONIN E NEVOJSHËM
PËR MARRJEN E STATUSIT TË
NDËRMARRJES SOCIALE

Në mbështetje të nenit 13, pika 3, të ligjit nr. 65/2016, datë 9.6.2016, "Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJ:

Fletoren Zyrtare", nënvizohet në udhëzimin e firmosur nga ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu.

Kërkesa për çregjistrim paraqitet pranë QKB

Tatimet: Procedurat që duhet të ndiqni, efektet dhe afatet e procesit

Personat që kanë një aktivitet tregtar dhe që duan të çregjistrojnë bizneset e tyre do të duhet që para se të nisin procedurën të paguajnë më parë të gjithë detyrimet tatimore të paguara. Kërkesa për çregjistrim paraqitet në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), sipas procedurave ligjore përkatëse. QKB-ja nga ana e saj, njofton Drejtorinë Rajonale të Tatimeve të juridiksionit përkatës, për regjistrimin e hapjes së procedurës së çregjistrimit të personit fizik. "Drejtoria Rajonale e Tatimeve të juridiksionit përkatës, brenda 10 ditëve pune nga marrja e njoftimit për fillimin e procedurave të çregjistrimit, kryen të gjithë verifikimet e duhura lidhur me situatën tatimore të tatimpaguesit person fizik që kërkon të çregjistrohet. Verifikimi përfshin të gjitha detyrimet tatimore, detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si dhe gjatë kohës së kamatëvonesat eventuale të lidhura me



këto detyrime. Drejtoria Rajonale e Tatimeve, përveç verifikimit të situatës tatimore të tatimpaguesit person fizik, kur e gjykon të nevojshme, mund të ushtrë edhe një kontroll tatimor në mjediset e personit fizik ku ai ushtron veprimtarinë e tij ekonomike. Ky

kontroll nuk mund të jetë më shumë sesa 30 ditë pune" shpjegojnë Tatimet. Nëse, nga verifikimet apo nga kontrolli në vend, rezultojnë se tatimpaguesi person fizik ka detyrime të paguara, gjatë kohës së kamatëvonesat, apo deklarata tatimore të paraqitura, Drejtoria Rajo-

AFATI

"Drejtoria Rajonale e Tatimeve të juridiksionit përkatës, brenda 10 ditëve pune nga marrja e njoftimit për fillimin e procedurave të çregjistrimit, kryen të gjitha verifikimet e duhura lidhur me situatën tatimore të tatimpaguesve persona fizikë që kërkojnë të çregjistrohen", shpjegojnë Tatimet.

Nëse, në kundërshtim me shkrim të paraqitur nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve, nuk është prezantuar shumica e detyrimeve tatimore të paguara të personit fizik, Qendra Kombëtare e Biznesit mund të kryejë çregjistrimin e saj. Kundërshtimi nga administrata tatimore është i vlefshëm dhe kur dërgohet elektronikisht sipas protokollit elektronik të shkëmbimit të të dhënave midis QKB-së dhe administratës tatimore. Për çdo çregjistrim të personave të tatueshëm, Qendra Kombëtare e Biznesit njofton Drejtorinë Rajonale të Tatimeve të juridiksionit përkatës. Për çdo çregjistrim të tatimpaguesve persona fizikë, Qendra Kombëtare e Biznesit njofton Drejtorinë Rajonale të Tatimeve. Drejtoria Rajonale e Tatimeve e juridiksionit përkatës është e detyruar që, brenda ditës së nesërme të punës pas marrjes së njoftimit nga QKB për çregjistrimin e tatimpaguesit person fizik, të bëjë çregjistrimin e tij edhe nga regjistri i tatimpaguesve të administratës tatimore.

DOKUMENTACIONI PLOTË

Ndërkaq, nëse dokumentacioni i paraqitur nga subjekti nuk është i plotë ose kur vlerësohet e arsyeshme, strukturat përkatëse mund të kërkojnë dokumentacion shtesë përveç atij të paraqitur nga kërkuksi. "Nëse vlerësohet e nevojshme, gjatë procedurës së vlerësimit të kërkesës, strukturat përkatëse pranë ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale mund të kryejnë vizitë vlerësuese në mjediset ku ushtron veprimtarinë organizata", thuhet në udhëzimin e publikuar dhe në Fletoren Zyrtare. Në çdo rast kërkuksi njoftohen

10 KËSHILLA PËR NXIRJEN PERFEKTE

SUMMER

pages

SUPLEMENT I GAZETIA SHQIPTARE

E mërkurë 15 Gusht 2018



**Roza Lati nuk di të ndalet,
pozon toples para pasqyrës**



**Ronela Hajati ka një
mesazh për "hejterat"**

**BULEVARDI
POLITIK**



- Artan dhe Ledi Shkreli kanë nisur pushimet kulturore
- Deputetja e PS-së të Elbasanit e del buzë detit me libër në dorë
- Bill Clinton arrin miliona shitje nga libri melodramë
- Ministri norvegjez jep dorëheqjen pse shkoi me pushime në Iran

*Jam i lumtur që kam marrë
vlerësime profesionale nga
artistët, por akoma edhe në
i lumtur me vlerësimet dhe
komentet nga njerëzit që
nuk merren me art, por që e
duan artin dhe të bukurën.*



Rëfëhet balerini: Ja e fshehta e videos që pati reagime, projekti im në Austri

MAJLAJDO GALA:

Dua të jem në një nivel me koreografët në botë

"Do të heq dorë nga baleti kur të mos kem më frymë"

Rrëfhet balerini: Ja e fshehta e videos që pati reagime, projekti im në Austri

Majlajdo Gala:

Dua të jem në një nivel me koreografët në botë

"Do të heq dorë nga baleti kur të mos kem më frymë"

Egla Xhemali

Ai ka prekur skenat e spektakleve më të dashura për publikun shqiptar e natyrisht është një nga balerinet dhe koreografët më të mirë që kemi pasur deri më sot. Bëhet fjalë për Majlajdo Galën, i cili kohët e fundit ka qenë në vëmendje të mediave dhe diskutimeve për shkak të një performance danci mbi takat të larta. Videoklipi me performancën që u quajt provokuese është realizuar nga vetë ai dhe është postuar në youtube, ku ka ngjallur një sërë reagimesh. Majlajdo për "Summer Pages" të "Gazeta shqiptare" na rrëfen të fshehtat e performancës në video, komentet që ka marrë, aventurat më të çmendura si dhe projektet e fundit në Austri. Balerini është mjaft i lumtur që po sjell risi në botën e artit në Shqipëri. Kjo frymë që ai përcjell e pasuron baletin si dhe e rrit atë edhe më shumë profesionalisht. Atij i pëlqen të eksperimentojë dhe shumica e atyre që e ndjekin rregullisht e kanë mirëpritur performancën e tij. Ai ka zgjedhur të jetë vet pjesë e videoklipit pasi të gjithë do shohin kur ta shohin tek realizohet në skenë. Koreografi na pohon se ka tre miq të shtrenjtë. Aventurat më të çmendura i kalon në stinën e dimrit i shoqëruar nga rrethi shoqëror. Gala thotë se nuk do heqë kurrë dorë nga baleti, pasi ai është pasioni më i madh që ka. Së shpejti ai do nisi një rrugëtim drejt suksesit në Austri e pritet



që të na surprizojë me projekte të tjera.

Videoja e fundit që ke publikuar përveç vlerësimeve ka pasur një sërë reagimesh. Pse ke zgjedhur të kërcesh mbi taka?

Jam i lumtur që kam marrë vlerësime profesionale nga artistët, por akoma edhe më i lumtur me vlerësimet dhe komentet nga njerëzit që nuk merren me art, por që e duan artin

dhe të bukurën. Zgjedha të kërcëja mbi taka pasi dua të jem në të njëjtin nivel me koreografët dhe balerinet në botë. Përveç kësaj unë e adhuroj artin e koreografisë dhe kërcimit. Jam non-stop në sfidë me veten duke e dërguar egon time në një shkallë më sipërore për të parë se çfarë unë mund të realizoj në këtë art kaq të bukur dhe shumë të vështirë.

Si i ke pritur komentet e njerëzve?

Në momentin që vendos të bëj një koreografi me taka 13 cm absolutisht kam pritur komente të ndryshme, por për ata që e ndjekin artin tim është diçka shumë normale, sepse tashmë janë mësuar dhe e duan atë pjesë që unë realizoj dhe eksperimentoj me çdo temë të mundshme, pasi i kam dhënë atë siguri, që çdo gjë që del nga emri im është profesionale, e bukur dhe artistike.

Lëvizjet e tua janë njësh me muzikën. Si lindi ideja e realizimit të këtij projekti? Pse zgjedhe të vije vetëm në të?

Unë kam realizuar edhe dy projekte përpara këtij. Ky është i treti dhe do pasojë edhe nga të tjerë. Dua t'i jap rëndësinë që duhet artit të koreografisë duke realizuar projekte, që të ngelen në historinë e kërcimit dhe që ta kërcëjnë balerinet e tjerë koreografinë time. Zgjedha të vija vetë në videoklip pasi në momentin ku KARK do vijë si performancë live në skenë dhe televizion do jetë një koreografi, ku ata që do e shohin do shtangen dhe shohin totalisht. Jam i lumtur që punoj me profesionist që e dashurojnë punën e tyre si Daino Ranks, Ola

Qato, Stella Sallaku, Artur Muca, Frame Pro Company dhe më kanë realizuar një projekt ku jam shumë i kënaqur nga të gjithë.

Ka pasur një moment që do e veçoje si më të bukurin në skenë?

Arti të jep shumë momente të bukura, që t'i përjetosh në skenë, por mendoj edhe pas kaq vitesh akoma nuk më ka ndodhur një moment ku do e veçoja dhe do e kujtoja.

Përveç baletit, cila është ajo gjë që të rrëmben kohën?

Baleti, koreografia, kërcimi dhe pedagogjia janë të ndërthurura me njëra-tjetrën aq shumë sa që edhe 24 orë nuk të dalin për të punuar dhe menduar mbi to. Nëse do kisha pak kohë dhe nëse do doja të më rrëmbente diçka kohën do ishte familja ime. Ata japin gjithë kohën për mua dhe ndihem keq që nuk mundem të jem më shumë i pranishëm, por fatmirësisht me kujtojnë dhe më mbështesin në profesionin tim.

Sa i shoqërueshëm është Majlajdo?

Nëse do të thosha jam shumë i shoqërueshëm do të gënjeja, prandaj të them të vërtetën unë shoqërohem me shumë pak njerëz. Kam tre miq shumë të mirë, që janë trekëndëshi im i Bermudës dhe jam me shumë fat që i kam.

Ke dashur të ndryshosh diçka nga vetja?

Është shumë e rëndësishme që ne ta duam veten ashtu si zoti na ka bërë. Nëse do kisha dashur diçka që ta ndryshoja do e kisha bërë, por jo funksionoj shumë mirë kështu siç jam.

Cila ka qenë vera më e çmendur e jetës tënde?

Unë verën nuk e preferoj shumë dhe e shijoj shumë pak, por çmenduritë më të mëdha i kam bërë në dimër dhe janë të pafundme. Nuk di se kë të veçoja sepse është njëra është më e bukur se tjetra, por të hipësh mbi makinë duke ecur në -17 gradë dhe të këndosh "Poker face" dhe me shumë video duke të xhiruar është çmenduri. Duhet të theksoj, që këto e shumë të tjera janë bërë pas shumë AMP - ve. Gjithmonë vetëm me miqtë e mi.

Si janë raportet e tua me kolegët? Ke më shumë miq apo armiq?

Ne nuk kemi kontakt me njëri-




Roza Lati nuk di të ndalet, pozon toples para pasqyrës

Prezantuesja e njohur Roza Lati, di gjithmonë se si të rrembejë vëmendjen e mediave. Ajo është një prej personazheve publike më aktive në rrjetet sociale, dhe shpesh ndan me fansat fotografi të ndryshme nga ditët e kësaj vere. Jo të pakta janë rastet kur Lati ka ndarë me fansat edhe ndonjë foto provokuese. Një të tillë, bukuroshja e ka publikuar së fundmi për ndjekësit e saj në 'Instagram'. Kësaj here, Roza shfaqet e veshur vetëm në të brendshme poshtë, ndërsa sipër është kreu i zhveshur. Ajo pozon 'topless' para pasqyrës, duke vënë në pah linjat e saj tërheqëse. Kjo foto ka arritur të marrë mijëra pëlqime, por as edhe një koment, kjo pasi Lati ka bllokuar hapësirën për komente.



Ronela Hajati ka një mesazh për "hejterat"

Ajo publikoi para tre muajve këngën, u pëlqye pafund nga fansat. Por, duket se ka persona që i urrejnë sukseset e arritura të Ronela Hajatit, për të cilën ajo ka një mesazh. Në fakt, bukuroshja ka reaguar përmes llogarisë personale në 'Instagram' duke treguar gishtin e mesëm. "Desha me i puth njëherë "hejterat", pastaj mendova, le të shkojnë në...", ka shkruar ndër të tjera ajo në rrjetet sociale. Kujtojmë se muaj më parë 28-vjeçarja kishte akuzuar kolegët për blerje të klikimesh në kanalet e ndryshme muzikore. Ronela tashmë është duke mbajtur disa koncerte dhe po punon në projekte që mesa duket do vijne shumë shpejt për publikun.




tjetrin sepse gjithmonë në projekte duhet vetëm një koreograf. Në mbrëmje dhe organizime ku mund të takohesh dhe të kuptosh raportet që ke, unë personalisht nuk shkoj. Ndërsa kontakte të tjera nuk kemi kështu që kuptohet nëse ke më shumë miq apo armiq. **A ke menduar ndonjëherë të heqësh dorë nga baleti?** Unë do heq dorë nga baleti vetëm kur mos të kem më frymë, pasi koreografia dhe kërcimi më mbajnë në jetë duke më dhënë frymë. Esh-të pasioni, dashuria, dëshira dhe ekstaza gjithçka është arti i kërcimit për mua ndaj nuk e mendoj ndonjëherë dhe nuk e mendoj, sepse unë e di se çfarë dua në jetën time. **Cilat janë projektet më të fundit? Ku do e shohim Majlajdon?** Projekti më i fundit ishte një koreografi, që realizova për divën e

muzikës Adelina Ismaili në një nga mbrëmjet më të rëndësishme të projektit të saj të fundit. Një performancë 45 minuta ku mora një satisfaksion shumë të veçantë. Projektet e mia janë shumë mirë të zgjedhura dhe të menduara. Koreografia e radhës do vijë përsëri me videoklip. Sapo kam përfunduar xhirimet, por për ta publikuar duhet të presim fundin e tetorit. Më besoni që prirja do ia vlej. Majlajdon duke filluar nga shtatori do e shohim në Austri pasi kam fituar një kontratë. As vet nuk e besoj që e kam arritur në një moshë kaq të vogël, por edhe pse e kam ditur gjithmonë që talenti nuk njih moshë kjo është një kontratë ku profesionalisht me dërgon në një nivel edhe më të lartë. Është një nga pikat e mia të synimeve dhe e arrita, por nuk po them asgjë më shumë thjesht presim shtatorin.

Kida, tejet provokuese e veshur me të kuqe

Kida është një nga këngëtalet që i kushton një vëmendje të madhe dukjes së saj. Ajo është një artiste me stil, këtë e tregojnë edhe fotot e fundit të postuara nga vet këngëtarja në rrjetin social "Instagram". Veshur me një bluzë të shkurtër të kuqe, ajo duket mahnitëse. Detaji tjetër është dhe buzëkuqi që kombinohet me bluzën e që po i shkon tej mase.



Artan dhe Ledi Shkreli kanë nisur pushimet kulturore

Zv.ministri i Infrastrukturës Artan Shkreli dhe ish-deputetja socialiste Ledi Shamku Shkreli njihen si çifti që ka një debulesë për artin e kulturën. Veç politikës dhe punëve në të cilat ata janë angazhur kanë ditë që bashkë me pushimet në det kanë nisur edhe eksplorimin në disa fshatra të vjetra në jug të vendit, në profilin e saj në 'Facebook', Ledi shkruan bashkë me një poezi:

"Lisa toka kish ndërruar,
Dhe në det ujë të ri
Ditësh të reja kaltëronte
Po pulëbardha e Anakreontit
Aq e moçme Tempë shkonte
Një ditë shkoi për ujë malit
E s'u kthye si e kish zakon"
"Këto foto, që stollisin vargjet e Milosaos së De Radës, sapo i shkrepnë në majën e Skutarës mbi Vunò (maja e Skutarës për vendësit). Në fshatin ku u dashurua Rina me Milosaon e ku po vajte, do magjepsesh edhe ti. Kisha e Shën Mërisë, ndonëse e braktisur, vijon t'i ruaje ende viset siç i tha Poeti i Arbërit:"Shën Mëri e shpivët tona këto udhë të m'i ruaj". Shpirt i Arbërit rron! Shpirtoooo, rrofsh sa jeta!



Deputetja e PS-së lë Elbasanin e del buzë detit me libër në dorë

Deputetja socialiste, Evis Kushi ka zgjedhur të bëjë disa ditë pushime në jug të vendit. Ditët e fundit ajo postoi një foto, ku e ulur buzë detit ka marrë në dorë një libër e ku duket se më shumë ka shkuar atje për të lexuar se sa për plazh, ose ndoshta ka qenë koha jo fort e mirë që nuk ka favorizuar ditën për plazh. Bashkë me foton, Kushi ka postuar edhe një shprehje në anglisht: "Sapo të mësoni të lexoni, do të jeni përgjithmonë të lirë".



BULEVARDI POLITIK

Na merrni seriozisht! 😊



Bill Clinton arrin miliona shitje nga libri melodramë

Bill Clinton është një tashmë një novelist që ka bërë miliona shitje. "Presidenti është i zhdukur", një melodramë e shkruajtur së bashku me James Patterson ka arritur më shumë se 1 milionë shitje në Amerikën e Veriut që prej 4 qershorit. Ky është libri i parë i tij me thriller, por me Patterson arriti të krijojë një prej romaneve më të suksesshme në botë. Ka pasur reagime të ndryshme për librin, por pronari i kompanisë së shitjeve "Barnes & Noble", Sessalee Hensley tha në një deklaratë të mërkurën se "Presidenti është i zhdukur" ka pasur shumë ndikim. Edhe shkrimtari Patterson bëri një deklaratë, ku thoshte se bashkëpunimi me Bill Clintonin ka qenë kulmi i karrierës së tij dhe se ish-presidenti do t'u sjellë lexuesve nga një këndvështrim i brendshëm se ç'do të thotë të jesh president.



Ministri norvegjez jep dorëheqjen pse shkoi me pushime në Iran

Ministri i peshkimit në Norvegji ka dhënë dorëheqjen pasi ka shkuar kaluar me të dashurën e tij iraniane. Por Sandberg pranoi se ai kishte shkuar atje me Bahareh Letnes, 28 vjeç, pa njoftuar kryeministrin dhe se kishte marrë telefonin e punës në Iran. Udhëtimi rrezikoi 58-vjeçarin duke ekspozuar tek spiunët iraniane, pasi ai nuk duhet të kishte marrë një telefon pune me vete. Letnes, e cila është shpallur Miss, menaxhon një biznes të eksportit të peshkut. Ajo ka rezidencë norvegjeze dhe ka mohuar ndonjë lidhje me qeverinë islamike të Iranit. Inteligenca norvegjeze është raportuar të hetojë aktivitetet e saj. Kryeministrja Erna Solberg tha se kishte urdhëruar Sandberg të dorëzonte telefonin e tij në polici për kontrollin e sigurisë. Ai, gjithashtu, ka dhënë dorëheqjen si zëvendës udhëheqës i Partisë së Progresit. Ushqimet e detit janë industria e dytë më e madhe e eksportit të Norvegjisë pas naftës dhe gazit.



AMF merr përsipër kompetencat e Byrosë, Fondi i Kompensimit shtesë me 181 milionë lekë



Autoriteti i Mbiqëqyrjes Financiare ka vendosur që të marrë përsipër kompetencat e Byrosë Shqiptare të Sigurimit në rastet kur kjo e fundit nuk bën shpërndarjen e praktikave të dëmeve pranë shoqërive të sigurimeve. Me një vendim të miratuar pak kohë më parë AMF ka bërë një shtesë në rregulloren "Për krijimin, llogaritjen, financimin, administrimin dhe kryerjen e pagesave të dëmeve". Shtesa është bërë në nenin 6 ku pas pikës 1 shtohet një pikë e re, e cila legjitimon ndërhyrjen e AMF duke

VENDIMI
AMF ka bërë një shtesë në rregulloren "Për krijimin, llogaritjen, financimin, administrimin e fondit të kompensimit dhe kryerjen e pagesave të dëmeve". Shtesa është bërë në nenin 6 ku pas pikës 1 shtohet një pikë e re, e cila legjitimon ndërhyrjen e AMF duke mundësuar kështu vijimin e procesit të shlyerjes së dëmeve.

mundësuar kështu vijimin e procesit të shlyerjes së dëmeve. "Në qoftë se Byroja Shqiptare e Sigurimit nuk bën shpërndarjen e praktikave të dëmeve të fondit të kompensimit tek shoqëritë e sigurimit anëtarë të saj sipas vlerave respektive të detyrimit të tyre, shpërndarja për pag-

esë tek shoqëritë e sigurimit, do të bëhet nga vetë Autoriteti. Byroja Shqiptare e Sigurimit brenda 7 ditëve nga data e marrjes dijeni nga Autoriteti të shpërndarjes së praktikës do të vijojë me dërgimin e autorizimit dhe kopien e praktikës tek shoqëria e sigurimit e caktuar nga

Autoriteti. Shoqëria e sigurimit ndjek procedurën e rimbursimit sipas parashikimeve të kësaj rregulloreje" thuhet në shtesën e bërë nga AMF. Një vendim tjetër i AMF i lidhur po me Fondin e Kompensimit bën një analizë të situatës së dëmeve. Kjo lidhet me një inspektim të kryer nga institucioni pranë shoqërive të sigurimit për ngjarjet e pas 1 janar 2014 si dhe pagesat e kryera për këto praktika gjatë periudhës janar-prill 2018. Sakaq edhe Byroja Shqiptare e Sigurimit, ka konstatuar se deri më 31

maj 2018, referuar situatës së dëmeve të fondit të kompensimit të papaguara për ngjarjet pas 1 janar 2014 e në vazhdim të përfunduara vlera e tyre në total është 229,058,962 lekë. Duke bërë vlerësimet për dëmet dhe nevojën për pagesën e tyre në respekt të afateve dhe objektivave AMF ka vendosur që të miratojë një shtesë tek Fondi i Kompensimit në vlerën 181 milionë lekë për vitin 2018. Detyra për njoftimin dhe shpërndarjen e detyrimit që kanë shoqëritë e sigurimit i është lënë Byrosë Shqiptare të Sigurimit.

UISSH: Kujdes, nuk ka afat tjetër! Dosja e plotë me dokumentacionin që duhet të paraqitni

Voltiza Duro

Zbardhen datat e regjistrimit për praktikën profesionale në fushën e mjekësisë

"Kur duhet t'i dorëzojnë dokumentet infermierët e fizioterapistët"

Prej 3 shtatorit të këtij viti të gjithë të interesuarit që dëshirojnë të kryejnë praktikën profesionale në një nga profesionet e rregulluara në fushën e mjekësisë duhet të bëjnë dorëzimin e dokumentacionit. Urdhri i Infermierëve të Shqipërisë i bën thirrje praktikantëve në Qarkun e Tiranës që të paraqiten për t'u regjistruar brenda afateve të përcaktuara pranë institucionit të UISSH. Gazeta Shqiptare publikon sot kalendarin kur praktikantët duhet të shkojnë të paraqesin dokumentet sipas profesioneve. Respektivisht në datën 3 dhe 4 shtator 2018, nga ora 9:00-12:00, do të paraqiten për të dorëzuar dosjet e tyre të gjithë fizioterapeutët që interesohen për ta filluar praktikën këtë sezon. Ndërkohë në 6 shtator, po në të njëjtin orar do të paraqiten për të dorëzuar dosjet e tyre të gjithë teknikët e imazherisë. "Në datën 7 shtator 2018, nga ora 9:00-12:00, do të paraqiten për të dorëzuar dosjet e tyre të gjithë teknikët e laboratorit që interesohen për ta filluar praktikën këtë sezon. Në datën 10 shtator 2018, nga ora 9:00-12:00, do të paraqiten për të dorëzuar dosjet e tyre të gjithë mamitë dhe logopedët që interesohen për ta filluar praktikën këtë sezon. Në datat 11-12-13-14 shtator 2018, nga ora 9:00-12:00, do të paraqiten për të dorëzuar dosjet e tyre të gjithë infermierët që interesohen për ta filluar praktikën këtë sezon", thekson Urdhri i Infermierëve të Shqipërisë. Ky i fundit më tej bën me dije se nuk do të ketë regjistrime në një profesion nëse data e tij ka kaluar, ndërsa të gjithë kandidatët që dëshirojnë të regjistrohen në qarqet e tjera, duhet të interesohen pranë zyrave në qendër qark ose të kontaktojnë me përfaqësuesit e UISSH në çdo rreth. "U njoftojmë se Urdhri i Infermierit të Shqipërisë vazhdon aktivitetin e tij në të njëjtin vendndodhje si më



REGJISTRIMI
Në datat 11-12-13-14 shtator 2018, nga ora 9:00-12:00 do të paraqiten për të dorëzuar dosjet e tyre të gjithë infermierët që interesohen për ta filluar praktikën këtë sezon", - thekson Urdhri i Infermierëve të Shqipërisë.

parë, por hyrja për në institucion bëhet nëpërmjet Q SH Nr. 4. Për këtë arsye, regjistrimet për praktikë për Qarkun Tiranë, do të zhvillohen sipas planifikimit për të mos krijuar probleme dhe vështirësi në shërbimin ndaj pacientëve të Q SH Nr. 4", thuhet në njoftimin e UISSH. **DOKUMENTACIONI**
Pas pajisjes me diplomë, të gjithë kandidatët do të bëjnë gati dosjen e tyre personale me dokumentet dhe do të regjistrohen në qarkun për-

katës për realizimin e Praktikës Profesionale me Mbiqëqyrje. Të interesuarit duhet të dorëzojnë këto dokumente: një kërkesë për anëtarësim (të cilën e shkruan vet personi i interesuar); diploma dhe lista e notave e notorizuar; fotokopje të kartës së identitetit, pesë fotografi; një CV (currrikulum vitae). Gjithashtu, kandidatët duhet të paraqesin edhe vërtetimin e Drejtuesit të Praktikës Profesionale (këtë e tërhiqni në momen-

KALENDARI SIPAS PROFESIONEVE

- ◆ Në datën 3 dhe 4 shtator 2018, nga ora 9: 00-12:00, do të paraqiten për të dorëzuar dosjet e tyre të gjithë fizioterapeutët që interesohen për ta filluar praktikën këtë sezon.
- ◆ Në datën 6 shtator 2018, nga ora 9:00-12:00, do të paraqiten për të dorëzuar dosjet e tyre të gjithë teknikët e imazherisë që interesohen për ta filluar praktikën këtë sezon.
- ◆ Në datën 7 shtator 2018, nga ora 9:00-12:00, do të paraqiten për të dorëzuar dosjet e tyre të gjithë teknikët e laboratorit që interesohen për ta filluar praktikën këtë sezon.
- ◆ Në datën 10 shtator 2018, nga ora 9:00-12:00, do të paraqiten për të dorëzuar dosjet e tyre të gjithë mamitë dhe logopedët që interesohen për ta filluar praktikën këtë sezon.
- ◆ Në datat 11-12-13-14 shtator 2018, nga ora 9:00-12:00, do të paraqiten për të dorëzuar dosjet e tyre të gjithë infermierët që interesohen për ta filluar praktikën këtë sezon.

DOKUMENTACIONI


- ◆ Kërkesë për anëtarësim (të cilën e shkruan vet personi i interesuar).
- ◆ Diplomë dhe listë notash të notorizuar.
- ◆ Fotokopje të kartës së identitetit.
- ◆ Pesë fotografi.
- ◆ Një CV.
- ◆ Vërtetimin e Drejtuesit të Praktikës Profesionale (këtë e tërhiqni në momentin kur dorëzoni dosjen pranë zyrës përkatëse dhe e plotësoni te personi që caktohet nga UISSH. Personi që plotëson Vërtetimin do t'iu ndjekë gjatë praktikës tuaj).
- ◆ Dërdhje në llogari të Urdhrit të Infermierit shumë prej 3000 lekësh në një bankë

tin kur dorëzoni dosjen pranë zyrës përkatëse dhe e plotësoni te personi që caktohet nga UISSH. Personi që plotëson Vërtetimin do t'iu ndjekë gjatë praktikës tuaj). Kandidatët duhet të bëjnë një dërdhje në llogari të Urdhrit të Infermierit në shumë prej 3 mijë lekësh në bankë. "Pas dorëzimit të dosjes kandidatët do të marrin dokumentet e mëposhtme: Librezën e Praktikës Profesionale, e cila përmban në pjesën e parë të saj informacion të përgjithshëm si dhe temat në lidhje me provimin e praktikës profesionale. Në pjesën e tretë të këtij dokumenti bëhen shënimet për çdo ditë të praktikës nga profesionisti që është zgjedhur si mbikëqyrës nga ana e kandidatit. Kjo Librezë pas përfundimit të praktikës, dorëzohet sipas njoftimit që del në faqen e UISSH pranë zyrës ku është bërë regjistrimi fillestar së bashku me dokumentet tjera. Karta e identitetit profesional, është një dokument identifikimi profesional e cila mbahet varur në përparësi gjatë ushtrimit të praktikës profesionale. Të gjithë kandidatët e interesuar për tu regjistruar në praktikë mund të paraqiten pranë zyrave përkatëse të UISSH sipas sezoneve", thekson Urdhri i Infermierëve të Shqipërisë.

DOKUMENTET

Kemi nevojë të sigurojmë jetën e një gruaje të quajtur XXXX nga Vlora, e cila ndiqet prej aferies së saj pse ajo nuk është martue me atë burrë që i kanë propozue prindërit, por ka dashur të vejë kunorë me një tjetër person

DASHURIA E H. e nderi i familjes 1929, shteti angazhohet të shpëtojë jetën e një vajze që kish dashuruar



Fatmira Nikolli

Rrekjet e Mbretërisë për të mbrojtur një vajzë

Ji lajmërojmë se kemi nevojë të sigurojmë jetën e një gruaje të quajtur XXXX nga Vlora, e cila ndiqet prej aferies së saj pse ajo nuk është martue me atë burrë që i kanë propozue prindërit, por ka dashur të vejë kunorë me një tjetër person me të cilin ka pasur relacione më përpara. Për këtë çështje jemi marrë vesh me Prefekturën e Shkodrës, e cila na siguron se po të urdhënojmë ajo Drejtorin e Drejtorinë e Spitalit të Shkodrës mund t'i sigurohet kësaj jeta duke e marrë në shërbim si ndihmës e motrave të spitalit.

Shëndetësisë sensibilizohet me rastin dhe e zbaton menjëherë kërkesën e MPB. Vajza shpërngulet në Shkodër për të shërbyer në spitalin e qytetit, duke marrë dhe një shpërblim të vogël si rrogë mujore, shënon Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave. Duke vënë në dukje se gjithsesi, drejtoria e spitalit paralajmëron se nuk është në gjendje të jetë përgjegjëse për sigurinë e jetës së saj, për shkak të frekuencimit të spitalit nga shumë persona. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave nxjerr një tjetër dokument ku vërehet se pas disa muajsh, më 3 shtator 1930, praktika shkoresse lidhur me H. nga Vlora rikthehet në veprim. Kësaj here për dy arsye: 1. Murgeshat (që shërbejnë në spital)

nuk dëshirojnë të kenë pranë një grua me moral të ulët, si H., që nuk i bindet familjes dhe martohet me burrin që dashuron; 2. Vëllai i H. i ka kërkuar spitalit, përmes një telegrami, të mësojë rreth gjendjes të së motrës. Në këto kushte, Drejtoria e Spitalit të Shkodrës, duke pasur frikë nga ndonjë incident, i kërkon Ministrisë së Punëve të Brendshme që të largohet H. prej spitalit. Ndërkohë, drejtori i spitalit nuk harron të kujtojë se shpërngulja e vajzës duhet të kryhet nën kujdesin e policisë, për të shmangur çdo rrezik. C'ndodh më pas me këtë vajzë? Praktika shkoresse ndalet këtu.... Po sot, ç'do të ndodhte me një rast të ngjashëm? Foto: AQS.H.

LETRAT Përgjigja për letrën e parë vjen pak ditë më vonë si vijon.

Ministris së Ptë Mbrendshme Tiranë Përgjigje e shkresës nr 1339, datë 14. 12.1929

Kemi nderin t'ju njoftojmë se porositëm drejtorin e spitalit në Shkodër që t'i sigurojë një vend atje pranë motrave infermiere gruas së quajtur XXXX nga Vlora, së cilës i shënuam spitalit që t'i paguajmë edhe një shpërblim të përmuajshëm.

Prandaj gruaia në fjalë mund të niset për në Shkodër.

Pas kësaj shkrese, vjen edhe përgjigja ku thuhet se pranojnë gruan, por nuk mbajnë përgjegjësi për çarë mund të ndodhë.

Drejtor:Përgjith. Shndesis.

Tiranë Gjeje e shkresës n.22, dt.16.12.929.

Ju njoftohet se më 20. 12. 929, kje prue në Spital prej anës Prefekturës e quejatuna H. Nga Vlora, ku ju dorzue motrave të Spitalit, për me përdore ndër shërbime të smutve, por si dihet, tuj kenë puan e sajë e komplikume (nonse këjo drejtori ka për ta pasë në kujdes) asht frigë se mundet me ndollë ndoj rrezik i pa pritun, prej ndonji personit të afermit të sajë ku nuk njiift, nder dit te lejes se njerzvet ku hinë e dalin me pa të smutit e vet, e prej të njekumve në ambulancë.


Kra, këjo drejtori, me gjithë kujdesin e plotë nuk mundet me nollj një përgjegjsi, në rasë të ndoj nolljes.


Sa për çashtjen e rrogës, jena të mendimiet me i dhanë friari 30 ne muj, posë ushqimit.

P.Drejt.e spitalit

Ministr'i Ptë Mbrendshme (Vula e firma) Drejtoria e Përgjithshme e Shëndetësisë 14/12/1929

Më 14 dhjetor 1929 Zyra Sekrete e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Mbretërisë Shqiptare i drejtohet Drejtorisë së Përgjithshme të Shëndetësisë dhe i kërkon ndihmë për t'i shpëtuar jetën vajzës H. nga Vlora, duke e punësuar atë në Spitalin e Shkodrës. Vajzës vlonjate i rrezikohet jeta prej familjarëve të saj, të cilët janë të gatshëm ta vrasin për të vënë në vend nderin e familjes. Duke mos dashur t'i bindet vullnetit të familjes për t'u martuar me burrin që i kanë zgjedhur, H. kërkon të lidhë martesë me burrin që ka dashuruar vetë, me të cilin, sipas shkresës, ka krijuar edhe marrëdhënie. Drejtoria e Përgjithshme e





← Dr.Basri Qallimi

Nga ana tjetër, edhe pse H ndërroi qytet paragjykimi e ndiqte nga pas. Si të mos mjaftonte familja që e ndiqte dhe morali i kohës, H-së i duhej të punonte me murgesha të cilat "mëkatini e saj" nuk e kishin fort të lehtë ta kapërdinin.

Mbretinjtë Shqiptare
Drejtorija e Spitalit të Shkodrës
Shkodër, më 3.IX.1930
P.T.
Drejt.Përgjith.Shndesis.
Tiranë

Si mbas shkresës të asajë P.T.Drejtori N.22 Res.dt 16 dhetuer 1929 për pranimin e gruas së XXXX nga Vlora.

Gruaja në fjalë si mbas urdhnit mahet në Spital si për ndihmë ndër do veprimet të vogla. Por tuj kenë sikur dihet ç'mo kohë gjendja e sajë (mbasi nuk ka një moral të shëndoshë) murgeshat e Spitalit nuk e donë që të mbahet ma gjatë në këtë spital. Ashtu edhe sot muermë një telegram nga Vlona prej të vllaut të sajë i quejtun XXXX ku kërkon me dije gjendjen e saj.

Pra për mos me ndollë një punë e keqe në kët spital, lutena me pasë mirsi grueja në fjalë të merret prej këtij spitali pa vonesë e të çohet m'nji vend tjetër si mbas pëlqimit të asajë.

P.T.Drejtori
Kohë më vonë një tjetër letër flet për çështjen. Është data 21. IX.1931. Ndohëse ka kaluar kohë, problemi mbetet i njëjtë dhe madje rreziku shtohet.

Drejtori e Përgjithshme e Shndesis
Tiranë

Patme lajme për largimin e të quejtunes XXXX nga Vlora e dërgume në këtë spital me shkresën n.22 Res Dt.16. 7.929 të asajë P.T. drejtori për shkak që ndiqte e kërkohet prej t'afërmit sajë. Tuj pa se gruaja në fjalë nuk ka një moral të shëndoshë duhet që të merret prej spitalit me anë të Policisë e për ta përcjellë ku ta shofin me arsye ajo Drejtori.

Xev.Drejtori i Spitalit
24.IX.1931

ZBULIM I MADH NË BERAT

Një "bazilikë" në këmbët e xhamisë Mbret

Aleksandër Meksi: Mozaiku u përket shekujve I-V



Mozaiku i zbuluar në Berat



MEKSI

I pyetur nga "Gazeta Shqiptare", Aleksandër Meksi tha se mozaiku mund të datojë nga shek. I deri në shek. V-VI. "Në Berat po bëhen punime restaurimi në Xhaminë Mbret faza më e vjetër e së cilës është fundi i shek.XV dhe lidhet me ardhjen e Sulltan e Bajazitit të II më 1492. Pranë xhamisë është tegeja e fundit të shek 18. Po bëhen restaurime me subvencion të TIKA-s dhe Ministrisë së Jashtme të Turqisë. Qëllimi është për ruajtja e vlerave, konsolidimi, forcimi dhe ruajtja e vlerave të objekteve në kuadrin e vizitueshmërisë së Beratit dhe objekteve të veçanta. Gjatë punimeve të përforcimit të themeleve të xhamisë, doli një varr dhe një mozaik, me ngjyra të kuqe e të bardhë që shtron detyrën për gjetjen e planimetrisë së ndërtesës e datimin e saj". Meksi shton se kjo, kërkon gërmimin jashtë mureve të xhamisë, rilevimin nga gjeologët me gjeoradarë, e duke punuar mbase të përfitohen të dhëna për muret e godinës.

gjithe sipërfaqen, përtej vijës së themelit të Xhamisë Mbret. "Në konsultim edhe me mbështetësin e pazëvendësueshëm të Trashëgimisë Kulturore, Profesor Aleksandër Maksin e anëtarët e Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë, do t'u paraqiten publikut dhe profesionistëve rezultate më të sakta të këtij zbulimi. Deri atëherë gjithçka thuhet e lexoj lart e poshtë, mbetet vetëm

hamendësim dashamirës e padurim i justifikuar i të apasionuarve për gjërat e bukur. Por as unë, e askush, nuk e fshehim emocionin që ngjall bukuria e mozaikut që shfaqet nën dhë, të cilit nuk do të ngutesha t'i vija asnjë epitet, por pa dyshim po për gatitimi për një destinacion të ri kulturor në hartën e Beratit. Kjo është pak, por e sigurtë!", përfundonte ministria.

"Godina mund të nisë në shek. 1 dhe deri në shek. 5-6. Edhe lart në kala kanë dalë mozaikë, qyteti ka ekzistuar. Ky është qyteti i poshtëm, ku ka pasur edhe ndërtime. Kjo është më interes. Ajo zonë është e mbushur me ndërtime. Është fragment dysHEMEJE, nuk e di nëse mund të ketë qëndër bazilikë".
fa.ni.

Opinion *i* Ditës

Turizmi dhe pushteti lokal

Nga Dr. Sorina Koti

(vijon nga faqja 1)

...gjeografik dhe klima kanë dhuruar një natyrë, që nëse do menaxhohej dhe investohej siç duhej, sot Shqipëria do ishte kthyer në një nga perlat e Mesdheut.

Për fat të keq, edhe pse janë kryer shumë investime, turistët reflektojnë pakënaqësi dhe reagime negative, si për nivelin e shërbimeve që ofrohen gjatë sezoneve turistike, ashtu edhe për infrastrukturën. Turizmi është përfshirë në strategjitë lokale dhe ato kombëtare të qeverisjes, herë të alternuara e herë të veçanta. Por, si e menaxhojnë bashkitë më të mëdha fluksin turistik?

Më poshtë janë analizuar bashkitë, të cilat kanë investuar në zhvillimin e turizmit bregdetar dhe malor. Frekuentimi i këtyre vendeve sjell edhe të ardhura në buxhetin e bashkive, nëpërmjet taksave lokale përkatëse. Taksa e hotelit është një nga taksat, që paguajnë turistët për fjetjen/akomodimin në hotele e bujtina. Tabela më poshtë tregon përqindjen që zë kjo taksë në totalin e të ardhurave vendore të bashkive.

Nga të dhënat e mësipërme shohim se kjo taksë kontribuon shumë pak në të ardhurat e bashkive, pavarësisht se nga viti 2016 në 2017, ajo ka pësuar një rritje të lehtë. Bashkitë e mësipërme kanë reklamuar dhe promovuar fort zhvillimin turistik të zonave të tyre dhe paralelisht kanë propaganduar vetëm rritje në numrin e turistëve. Atëherë, ku kanë shkuar të ardhurat e turizmit dhe pse nuk reflektohet taksa e hotelit në të ardhurat e bashkive?


Bazuar edhe në analizën e buxheteve bashkiake, vërehet se kjo taksë mbledhet në masën 40-45% në raport me objektivat vjetore të paravendosura për këtë zë. Realiteti tregon një problem, që po trashëgohet nga viti në vit. Numrat në rritje të bujtinave dhe hoteleve të reja të ndërtuara së bashku me fluksin në rritje të turistëve vendës dhe të huaj, që frekuentojnë vendin tone, nuk reflektohen në mirëqenien financiare të bashkive. Dy nga arsyet mund të jenë: evazioni i lartë nga ana e hoteleve në deklarimin e një numri më të vogël shtetërisht sesa realiteti, kjo për të mos paguar taksën e hotelit; si dhe argumenti tjetër mund të jetë turizmi njëditor, i cili nuk prenoton hotel për fjetje. Argumenti i parë është i lidhur drejtpërdrejt me efikasitetin e autoriteteve lokale, në evidentimin e plotë të kapaciteteve akomoduese nga subjektet private dhe



Tabela 1. Taksa e hotelit, si % e totalit të të ardhurave vendore nga taksat dhe tarifat

T3	Durrës	Himarë	Konispol	Korçë	Lezhë	Pogradec	Sarandë	Vlorë
2015	0.51%	3.21%	0.1%	0.72%	0.64%	1.72%	4.22%	1.07%
2016	0.58%	2.12%	0.04%	0.47%	3.57%	1.2%	6.82%	0.54%
2017	0.71%	2.61%	0.04%	0.61%	2.67%	1.53%	7.47%	0.59%

Tabela 2. Shpenzimet vendore



Burimi: financatvendore.al

fiskal, konkurrencë të ndershme dhe rritje të të ardhurave bashkiake.

Nga ana tjetër, bashkitë investojnë dhe shpenzojnë fonde publike për të nxitur numrin e turistëve dhe për ta bërë zonën më tërheqëse. Tabela më poshtë tregon shpenzimet në sektorët më kryesorë, ku fokusohet vëmendja dhe nevoja e një turisti gjatë qëndrimit të tij.

Burimi: financatvendore.al
Të dhënat e mësipërme tregojnë se bashkitë Korçë dhe Durrës kanë investuar më shumë në transport dhe shpenzime kapitale (kryesisht shtrim rrugësh, shkolla, qendra shëndetësore). Problem ngalet furnizimi me ujë, siguria, mbrojtja e mjedisit dhe shërbimet e përgjithshme publike (ndriçimi, pastrimi dhe gjelbërimi). Përveç Bashkisë Korçë, e cila ka investuar edhe në zërat e argëtimit-kulturë dhe çështjeve me karakter fetar, bashkitë e tjera janë pothuajse të pandjeshme në këtë fushë. Gjithsesi, fondet e investuara nga bashkitë janë shumë të vogla në krahasim me nevojat, që turistët vendës dhe të huaj kanë. Investimet publike nga bashkitë janë akoma më të vogla në bashkitë e jugut, ku si rrjedhojë edhe cilësia e shumëllojshmëria e shërbimeve në funksion të turizmit lenë shumë vend për të dëshiruar.

Turistët kanë prioritet sigurinë, ujin, ndriçimin, infrastrukturën rrugore dhe shëndetësore, por gjithashtu edhe mjedisin kulturor, social, natyrën dhe aktivitetet e organizuara nga bashkitë, për të bërë të shumëllojshëm dhe të plotë pushimet e tyre. Nga gjuha e statistikës konstatohet se, shumë pak nga bashkitë me numër të rritur turistësh ofrojnë shërbimet e mësipërme. Realiteti është jo aq "rozë" sesa marketohet nëpër media.

Statistikat e mësipërme na vënë në dukje se sa shumë probleme ka turizmi në Shqipëri dhe sesa nevojë imediate ka për ndërhyrje në ujësjellës, siguri publike, shërbime publike dhe infrastrukturë rrugore. Kjo mënyrë e të parit të realitetit kërkon një reagim të shpejtë nga ana e institucioneve publike, duke e konsideruar në veprime, turizmin si prioritet zhvillimor kombëtar.

Zhvillimi i konsoliduar i turizmit do të sillte më shumë të ardhura si për bizneset, ashtu edhe për vetë bashkitë, të cilat më pas do reflektoheshin në rritjen e shpenzimeve vendore.

Turizmi në Shqipëri është në një proces zhvillimi dhe përmirësimi, duke u frekuentuar kryesisht nga turistët rastësorë dhe jo të organizuar. Nevojiten shumë investime kapitale, por edhe burime njëzërore për një turizëm të shtrirë gjatë muajve të vitit, sa më cilësor dhe tërheqës.

mbledhjen korrekte të taksës përkatëse.

Problem tjetër është mungesa e një regjistri zyrtar në nivel bashkie, për numrin e hoteleve, bujtinave ose operatorëve të tjerë, që ofrojnë shërbime hotele dhe sa shtretër ka secili prej tyre. Mosdeklarimi/informaliteti nga ana e hoteleve për shtretërit e zënë është shumë i lartë dhe kjo reflektohet në të ardhurat e ulëta, që bashkitë arketojnë nga taksa e hotelit. Pjesa më e madhe e operatorëve punojnë me regjistra të dubluar fjetjeje dhe më pas me deklarimin tatiimor fals. Kjo situatë mund të përmirësohej nëpërmjet kontroleve të vazhdueshme dhe jo selektive nga ana e autoriteteve, duke ndikuar drejtpërdrejt në uljen e evazionit

Opinioni *i* Ditës

Nga "Birra Korça Fest", te diplomacia kulturore

Nga Dr. Jorgji Kote

(vijon nga faqja 1)

...që ka vazhduar pa ndërprerje deri ditët e sotme. Duke u bashkuar me vlerësimet e shumta pozitive, dua të veçoj meritën e madhe të drejtuesve të kompanisë me emër dhe organizatorëve që e kthyen atë në një festival të vërtetë të kulturës me përmasa shumë më të gjera e ku "Birra Korça" ishte sebebi dhe lezeti i asaj feste.

Falë dhe pjesëmarrjes rekord me mbi 100.000 vetë, Korça u kthye për një javë rresht në një Mynih të vogël dhe në një "October Fest" bavarez me origjinalitetin e vet.

Prania dhe e mijëra turistëve, vizitorëve dhe personaliteteve të huaja nga shumë vende ishte dëshmi bindëse e përpjekjeve të shumta të drejtuesve të saj për të zgjeruar gjeografinë e "Birra Korça Fest".

E theksojmë këtë element jetik, sepse veç vlerave të tjera birra "Korça" bashkë me kulinarinë dhe pijet tona elitare është bërë kartëvizitë tërheqëse edhe për diplomacinë tonë; dimensionin kulturor i kësaj të fundit nuk mund të jetë i plotë pa i përfshirë ato shumë më gjerë se deri tani në veprimtarinë e saj sidomos jashtë vendit.

Përvoja moderne diplomatike, sic e kam përmendur dhe në librin "Diplomacia për të gjithë" (2014) tregon me plot shembuj se delikatesat kulinare dhe pijet elitare i kanë kaluar me kohë kujtije të zakonshme të një procesi biologjik dhe konsumi. Ato janë bërë marka dhe shenja daluese të identitetit, kulturës dhe krenarisë të një shteti. Përmend, bie fjala, "spageti, parmësana, paella, salsicë, kavjar, schnitzel, sushi, frite" dhe vështirë se do të ketë njeri që nuk njih vendet që ato përfaqësojnë me imazhin dhe vlerat/traditat shqiptare. Veç kësaj, ato janë kthyer në ideologji dhe simbole të një sistemi dhe mënyre jetese, institucione të vërteta të kulturës, imazhit dhe turizmit me ndikim jo vetëm në cilësinë dhe standardet e jetesës, por dhe në negociatat dhe proceset e ndryshme politike dhe diplomatike.

Sa për ilustrim, "October Fest"-i i famshëm gjerman filloi dhe si festë birre 140 vite më parë, por shpejt ai u bë një festë shumë më e gjerë popullore, demonstrim i njohur ndërkombehtar i vlerave dhe traditave më mira të Bavarisë së mirënjohur. Sapo Sarkozy u zgjodh President i Francës më 2007, ndër projektet e para të suksesshme ishte shpallja e gastronomisë franceze si trashëgimi kulturor e UNESCO-s; kurse Belgjika e ka bërë këtë për birrën e saj elitare me 800 lloje, si një nga tempujt e kulturës së saj.

Nisur nga sa sipër, prania e pijeve tradicionale dhe me emër sidomos shampanja, vera, birra, konjaku, etj. është "Must", pra domosdoshmëri në koktejet, bufetë dhe pritjet diplomatike, festimin e Ditës Kombëtare jashtë vendit, etj.

Gjithashtu, ato janë bërë pjesë për-



bërëse e veprimtarisë së diplomacisë së sotme, ku pas shijimit të specialiteteve të ndryshme kulinare, interesi, klima dhe atmosfera e nevojshme për trajtimin dhe të çështjeve më delikate bëhet më i madh.

Një kolegj diplomat në Bruksel më tregonte se gjatë Presidencës së radhës të BE-së në vitin 2011 Hungaria i ishte kushtuar rëndësi të posaçme pranisë së verës së saj të njohur "Tokay". Ajo kishte qenë në "krye të vendit" në të gjitha ato qindra takime, kokteje, veprimtari dhe festa. Në nëntor 2013, gjigandi i televizionit italian, Bruno Vespa erdhi në Tiranë për të dytën apo të tretën herë, për të bërë degustimin e një vere puljeze në ambasadën italiane në Tiranë!

Tanimë është bërë praktikë e zakonshme në metropolet kryesore të botës që shumica e përfaqësive diplomatike, përfshirë dhe ato të vendeve më të vogla se ne të organizojnë mbledhje të posaçme për degustimin e verës dhe pijeve të tjera cilësore. Ambasada e Maqedonisë në vendet kryesore të botës, në shumë fesa, nuk harron të përmendë se aktiviteti do të mbyllet me verë vendase, që ka efektet e saj për një prani më të madhe.

Ja pse, jehona tingëlluese e "Birra Korça Fest" shërben si shtysë dhe nxitje për më tej, përfshirë dhe "eksportin" e kësaj veprimtarie jashtë vendit. Mbi bazën e përvojës sonë diplomatike, sidomos deficiteve në këtë fushë, pa qenë nevoja për analiza akademike, më poshtë po japim disa sugjerime konkrete mbi forcimin dhe pa-

surimin e dimensionit kulturor të diplomacisë sonë me ngjarje dhe marka të tilla si "Birra Korça".

Le ta fillojmë me mundësinë e saj për të qenë e pranishme në "Festivalin Ndërkombëtar të Birrës" që zhvillohet prej 22 vitesh çdo gusht në qendër të Berlinit. Në fakt, ai është kopshiti më i madh i birrës në botë me 2,2 km gjatësi, duke hyrë dhe në Librin e Rekordve Guinness. Gjatë tri ditëve, aty konsumohen 2400 lloje birra të 350 birrarive nga 90 vende të botës, me mbi 800.000 vizitorë. Birra shoqërohet me këngë dhe muzikë në të 19 skenat e ngritura me këtë rast. Sivjet e ftuara e ndëriri ishte Zelanda e Re me logon "Birrë nga pjesa tjetër e botës". E tepërt të komentojmë efektet e mëdha të pranisë së birrës "Korça" apo dhe "shoqevë" të saj në këtë paradë të birrës, si pjesë e kulturës botërore.

Së dyti, është plotësisht e mundur që me mbështetje të ambasadeve tona, Dhomave të Tregtisë, Agjencive të Turizmit dhe kompanie prodhuese të birrave dhe pijeve të tjera cilësore të organizohen në disa prej metropoleve kryesore evropiane minifesta si ajo e Korçës apo dhe Festa të Verës shqiptare. Si fillim, kjo mund të bëhet në lokalitetet prestigjioze të bashkatdhetarëve ose dashamirësve tanë të huaj ose në vende dhe sheshe të njohura, të shoqëruara me këngë, valle dhe muzikë tradicionale dhe moderne me grupet amatore si dhe të ardhur nga Shqipëria.

Prania e Tiranës dhjetorin e

kaluar në Panairin Ndërkombëtar të Dimrit 2017 në Bruksel ku pijet tradicionale ishin "Mysafir i Nderit" dëshmuar se me një kujdes më të madh suksesi në këtë fushë deficitare është i garantuar.

Këto ditë ose javë festive mund të organizohen dhe me rastin e panairëve/ekspozitave tregtare apo festivaleve kulturore ku si diplomatë, me ndonjë përjashtim të rrallë jemi ndërjetë ngushtë, sepse e vetmja gjë e shumëdëshiruar, por që ka munguar kanë qenë delikatesat dhe pijet shqiptare. Në shumë raste, organizatorët e një aktiviteti kërkojnë nga Ambasada vetëm ndonjë pije ose delikatesë, sa për lezet" madje dhe me pagesë e që nuk u realizohet. Mundësi të tjera të mira janë dhe vizitat e drejtuesve tanë të lartë jashtë vendit, ku ky aspekt lihet padrejtësisht "prapa liste"; si diplomat, në jo pak raste më ka ndodhur që gjatë koktejit përmbyllës me rastin e një vizite të nivelit të lartë, duke shijuar verën e ofruar të ftuarit tanë janë zhgënjyer kur kanë dëgjuar se ajo nuk është shqiptare. Vërtet që vera e huaj mund të jetë më e mirë dhe markë më e njohur, por kur ajo është "shqiptare" i tejkalon avantazhet e kujtdo marke. Sepse siç u tha, birra "Korça" krahas freskisë dhe shijes përcjell më shumë historinë, traditat, kulturën dhe vlerat e popullit dhe shoqërisë së saj.

Në këtë drejtim, me gjithë hapat dhe arritjet duhet të bëjë shumë më tepër MPJ-ja jonë për të mbështetur sidomos Përfaqësitë tona kryesore diplomatike. Në fund të viteve '90 rifilloi dërgimi nëpër ambasadë jashtë vendit i sasive të caktuara me pijet tona tradicionale - verë, rakë, birrë e konjak, të cilat servirohen në kokteje e pritje dhe në raste të vizitave të ambasadorëve dhe personaliteteve të ndryshme. Për fat të keq, kjo praktikë e dobishme ka vite që është ndërprerë.

Për realizimin e këtyre hapave me gjithë problematikën ekzistuese pengesa kryesore nuk janë fondet financiare, por mungesa e vlerësimit të duhur të këtij aspekti dhe shikimi thjesht e vetëm nga ana kontabile. Për më tepër, MPJ ka nënshkruar disa marrëveshje me Dhomat e Tregtisë, Agjencitë e Turizmit dhe prodhues të ndryshëm që kanë mbetur "të fjetura" dhe që do të ndihmonin mjaft në zgjidhjen e këtij aspekti të rëndësishëm të diplomacisë sonë në përgjithësi dhe dimensionit kulturor në veçanti.

Së fundi, dhe më e rëndësishmja, sado të mëdha të jenë shpenzimet për sa sipër, sërish ato mund të llogariten dhe përballohen me këtë bashkëpunim; por në çdo rast ato janë shumë më të vogla se përfitimet për imazhin e vendit të cilat janë të pallogaritshme. Ja pse festa dhe marka të tilla si "Birra Korça" duhet të bëhen sa më shpejt e më shumë pjesë e pandarë e dimensionit kulturor të diplomacisë sonë.

HOROSKOPI

DASHI

Përpikuni të largoni nga mendja mendimet negative. Do të argetoheni shumë nëse gjatë ditës kaloni momente edhe me familjarët tuaj. Të ardhurat do të rriten shumë gjatë ditës së sotme. Sa i përket anës romantike, do të ndiheni shumë të lumtur.

DEMI

Sot do të keni kohë mjaftueshëm për të bërë ushtrime fizike, të cilat do të ndikojnë mjaft mirë në shëndetin tuaj. Ka gjasa që gjatë ditës të përballeni me një konflikt. Kërkonti mbështetjen e familjarëve për t'ju ndihmuar në këtë çështje. Partner/partnerja juaj do t'ju përgatisë diçka shumë speciale.

BINJAKET

Sot do të ndiheni plot energji dhe gjithçka në punë do ta realizoni shumë më shpejt se zakonisht. Një projekt i rëndësishëm, të cilin keni kohë që e prisni të realizohet, do të vazhdojë të vonohet. Përpikuni të shmangni njerëzit që kërkojnë të lëndojnë reputacionin tuaj.

GAFORJA

Mos u varni tek fati dhe përpikuni të kujdeseni më shumë për shëndetin tuaj. Është koha e duhur të kontrolloni peshën dhe të filloni ushtrimet fizike. Parashikohet të keni rritje të të ardhurave. Sa i përket anës romantike, ka gjasa që sot të zhgënjeheni.

LUANI

Suksesi është shumë pranë jush. Do të keni rritje të shpenzimeve, çfarë do t'ju shqetësojë. Sot duhet të përdorni inteligjencën dhe influencën tuaj për të zgjidhur disa çështje familjare. Bëni kujdes me sjelljen pasi mund të lëndoni të afërmit tuaj. Çiftet e martuar do të konfliktohen, gjë që do të prishtë harmoninë.

VIRGJERESHA

Duhet të relaksoheni patjetër, që të fitoni energjinë e humbur. Ka gjasa të shpenzoni më shumë se buxheti juaj duke ju shkatërruar disa projekte. Çiftet e martuar, pas një periudhë të vështirë, më në fund do të shohin "diell".

PESHORJA

Personat që vuajnë nga stomaku duhet të shmangin ushqimet e yndyrshme, pasi ndikojnë negativisht në shëndetin e tyre. Problemet financiare do t'ju bëjnë që të mos mendoni në mënyrë konstruktive. Mos ia impononi mendimin tuaj të tjerëve, pasi do të përballeni me konflikte.

AKREPI

Sot do të keni mundësi të qëndroni më shumë me familjarët tuaj. Marrëdhënia me personin tuaj të zemrës nuk do të jetë siç duhet, për shkak të ndërhyrjes së dikujt. Komunikimi do të jetë pika juaj e fortë.

SHIGJETARI

Kontrolloni emocionet tuaja dhe çlirohuni nga frika sa më shpejt të jetë e mundur. Sot do të fokusoheni në disa çështje si pasuritë e patundshme dhe projektet kulturore. Ndërsa për disa çështje të tjera do të bëni mirë të kërkonti ndihmën e prindërve, pasi do të jetë shumë e vlefshme për ju.

BRICJAPI

Disa prej jush kanë punuar me orar të zgjatuar kohë e fundit, ndaj duhet të krijoni mundësinë për tu relaksuar. Përpikuni të mos shpenzoni shumë për t'u argetuar. Disa debate në familje do të mërzisin të afërmit tuaj. Tregohuni shumë të vëmendshëm, kur bisedoni me persona të rëndësishëm.

UJORI

Tregoni kujdes të veçantë gjatë ditës së sotme, në mënyrë që të shmangni një incident fizik që mund t'ju lëndojë. Kërkonti një marrëdhënie të re, e cila do t'ju lumtojë. Bëni kujdes me fjalët dhe veprimet, në mënyrë që të mos lëndoni njerëzit përreth jush.

PESHQIT

Natryja juaj impulsive mund t'ju shkaktojë disa probleme shëndetësore. Diskutoni projektet tuaja të rëndësishme me familjarët. Sa i përket anës romantike, do të jetë dita juaj me fat. Çiftet e martuar do të kalojnë një ditë të mbyshur plot argetim.

Lista e pestë me pronarët që do të kompensohen për tokat e sekuestrua në '45-ën

Ornela Manjani

Buxheti, 15 miliardë lekë për pronarët, 5 mijë përfitues në të gjithë vendin

ATP ka miratuar kompensimin për dosjet 2001-2014

Qeveria ka miratuar një fond prej 15 miliardë lekësh, të cilat do të shpërndahen për të paktën 5 mijë pronarë, të cilëve u është njohur e drejta e kompensimit të pronës dhe s'kanë marrë deri tani asnjë këst. Fondi është i ndarë në tri vite 2019-2022, i cili rritet progresivisht vit pas viti. Në projektbuxhetin afatmesëm është miratuar fondi për vitin 2019 në vlerën 4,9 miliardë lekë, për vitin 2020 në vlerën 5,3 miliardë lekë dhe për vitin 2021 në vlerën 5,4 miliardë lekë. Sipas ligjit në fuqi, pronarëve që u është njohur e drejta për kompensim do të marrin 20% të vlerës në lekë dhe pjesën tjetër 80% kompensim me

tokë. Ndërkohë pronarët mund të aplikojnë për të përfituar nga skema për pagesa të përshpejtuara.

TRI AFATET

Janë vendosur tri afate pagesash të përshpejtuara. Pagesë brenda një viti, brenda tri vitesh dhe brenda pesë vjetësh. Për secilin variant në një VKM të posaçme është përcaktuar edhe përqind-

ja e pagesës. Për pagesën brenda një viti pronari merr 20% të vlerës së faturës, për pagesën brenda tri viteve merr 30% dhe brenda pesë viteve merr 40% të vlerës së kompensimit dhe heq dorë nga pjesa tjetër e kësaj vlere. Të gjitha subjektet që kanë një vendim përfundimtar kompensimi, pavarësisht ren-

dit kronologjik të tij dhe llojit të zërit kadastral të pronës së vlerësuar, kanë të drejtë të aplikojnë pranë ATP-së me kërkesë të veçantë, ku shprehin vullnetin për t'u kompensuar financiarisht. Kërkesat e veçanta për kompensim financiar do të trajtohen sipas kësaj procedurë: nga çdo fond vjetor buxhetor i

kompensimit financiar, jo më shumë se 1/3 e tij mund të përdoret për kërkesat e veçanta të kompensimit financiar, të gjitha subjektet kërkuese që shprehin vullnetin për t'u kompensuar financiarisht me kërkesë të veçantë duhet të aplikojnë pranë ATP-së brenda vitit të çeljes së fondit vjetor buxhetor të kompensimit finan-

ciar. Pas aplikimit për kompensim financiar me kërkesë të veçantë, ATP-ja përgatit vlerësimin financiar të pronës, pavarësisht rendit kronologjik të vendimit dhe në rastin e disa aplikimeve për kompensim me kërkesë të veçantë do të zbatohet rendi kronologjik i datës së vendimeve për këto aplikime.

PËRFITUESIT NË TË GJITHË VENDIN


32	Dibër	DIELLI, TEUTA SHEHI (URUÇI)-4,301,186
33	Elbasan	LUMNIS ÇELA -80,809,858
34	Fier	Shpresa Mina
35	Fier	Drita Meta 18,044,856
36	Fier	Koçi Stroni 9,669,750
37	Fier	Rexhep Kuçi 3,578,561
38	Gjirokastrë	At.Thanas Qerimi
39	Vlorë	Gëzim Braka
40	Berat	Alfred Shabani 5,481,000
41	Berat	Enrikena Lako 7,028,422
42	Berat	Petraq Marini
43	Fier	Viktor Zaka 27,330,400
44	Fier	Nuri Koreshi 5,014,240
45	Gjirokastrë	Ismail Kuka 16,662,681
46	Gjirokastrë	Sokol Musa Mane 8,489,600
47	Korçë	768,000
48	Lezhë	Brahim Leknikaj
49	Korçë	Drita Zeqir Xhimanki 500,000
50	Korçë	Fadile Pallani (Rovi) 5,451,040
51	Berat	Pëllumb Veçani
52	Korçë	
53	Berat	Jorgji Xhaxha 3,532,200
54	Tiranë	BAJRAM,KADRI ALIMEHMETI 10,514,133
55	Korçë	Gjenci Ligor Xhufka 4,506,300
56	Korçë	THOMA ALUSHI 16,465,000
57	Vlorë	Aranit Gega 1,054,825
58	Vlorë	Shpetim Sharra
59	Elbasan	MERJEME ISMAILI
60	Korçë	Eqerem Vesel Bajram 1,231,600
61	Lezhë	Agustin Lucaj 652,538
62	Elbasan	ISMETE GRIPSHI
63	Gjirokastrë	Vangjel Jorgo Tasi844,200
64	Gjirokastrë	Vasil Dede -2,784,192
65	Gjirokastrë	Dhimiter Vasil Dede 5,824,640
66	Vlorë	Lavdie Qesari -20,779,850
67	Gjirokastrë	Leferia Bako -69,752
68	Berat	Sami Cufe 1,290,384
69	Gjirokastrë	Vangjel Dhimiter Kacifa-117,248
70	Vlorë	Dejvin Sharra -122,746,891
71	Berat	Veli Salillari 21,524,090
72	Berat	Mustafa Xherimeja 8,047,935
73	Korçë	Bilal Hysi
74	Korçë	Kike Qamil Mankolli 810,000
75	Durrës	Bashkim Belegu 48,752
76	Korçë	LULE NAUNI(MEHMETI)
77	Tiranë	Vath Nuredin Ibra 6,580,000
78	Fier	Agim Velaj 17,405,550
79	Korçë	Valentina Trebiska 0
80	Tiranë	FLUTURA SOKOLI 11,384,730
81	Korçë	Isuf Selim Limonas 4,633,000
82	Korçë	Zhaneta Koste Nasi 68,921
83	Korçë	Qamiran Tahir Kilomollari
84	Gjirokastrë	Avdul Kadri dhe trashëgimtaret e tjerë Kazma -5,916,344
85	Dibër	Ndue Lalaj
86	Tiranë	SHYQYRI HYSKJA 73,665,900
87	Berat	Iskra Myftari 42,432,000

88	Berat	Koci Beqollari 958,608
89	Gjirokastrë	Dashamir Gega -12,896,143
90	Gjirokastrë	Hiqmet Hajri Hodo374,535
91	Korçë	Gaço Bola Lola 848,600
92	Durrës	Sulejman Kapedani 5,696,000
93	Durrës	Sulejman Kapedani 23,751,000
94	Durrës	Sulejman Kapedani 7,120,000
95	Berat	Agron Ago 72,270,030
96	Berat	Gjylshah Shkurti (Vrioni) 8,853,641
97	Durrës	Mehmet Kasmi 31,680,000
98	Korçë	Eqerem Vesel Bajrami 18,660,000
99	Dibër	Veli Çipuri -10,424,011
100	Dibër	Hysni Çipuri -4,083,789
101	Dibër	Ali Çipuri -2,186,683
102	Dibër	Ali Çipuri -4,713,584
103	Fier	Agim Jaupaj 1,967,385
104	Korçë	MYNEVER LUFO (HADRI)479,400
105	Korçë	Petraq Nase 378,018
106	Gjirokastrë	Jorgji Mithat Lahe -124,124
107	Dibër	Kaplan Stojku 250,355
108	Gjirokastrë	Foto Andonja1,175
109	Korçë	Irma Tomco 680,000
110	Elbasan	ARBEN HOKHA 3,760,000
111	Gjirokastrë	Barjam Mehmetaj -8,705
112	Durrës	Erqan Hysni Tivari, Vezir Barolli 5,205,200
113	Elbasan	BEDRI BEHELULI -6,204,618
114	Lezhë	Llesh Geg Perla 8,942,065
115	Kukës	Bajram Ahmet Babqorri
116	Kukës	Ramadan Bek Babqorri
117	Korçë	Dhori Janaq Bendo 3,180,000
118	Gjirokastrë	Shpetim Alite 161,910,400
119	Gjirokastrë	Shpetim Alite
120	Elbasan	NAJDA PEPELEKAJ 2,680,440
121	Gjirokastrë	Niqifor Miltiadh Gjoka -171,728
122	Korçë	Lumke Duci (Hibo) 6,000,120
123	Korçë	Aslan Shefki Sulçe 10,491,000
124	Tiranë	FADIL ZELA 1,144,800
125	Gjirokastrë	Jorgji Kulla -347,495
126	Korçë	Fatmir Qamil Pallani
127	Korçë	Fatmir Sefedin Metko
128	Elbasan	ETHEM LULJA 2,733,200
129	Durrës	Mahmut Bobrati
130	Korçë	Kostandin Thimi Peco 400,000
131	Korçë	Agim Hasan Shalli 8,815,000
132	Korçë	Jordan Xoga 2,399,000
133	Tiranë	AFERDITA XHEPA (HUTA)10,080,000
134	Korçë	XHUVI PELTEKU -36,998,115
135	Berat	Ervin Selman Numani 301,176
136	Berat	Agron Veli Spahiu 3,772,755
137	Korçë	Ramadan Haxhi Mukollari 376,320
138	Durrës	Luljeta Çelkupa
139	Durrës	Luljeta Çelkupa
140	Durrës	Luljeta Çelkupa
141	Durrës	Luljeta Çelkupa 10,586,728
142	Berat	Jorgji Toli Myzeqari 1,015,000
143	Berat	Dhimitër Petro Gjini
144	Kukës	Drita Ali Duki
145	Kukës	Qemal Hajredin Gjana

146	Berat	Qemal Hysen Bega 9,551,300
147	Gjirokastrë	Vasil Thomollari 168,000
148	Gjirokastrë	Vasil Thomollari 5,817,952
149	Gjirokastrë	Vasil Thomollari 896,000
150	Korçë	Vangjel Koço
151	Berat	Sefedin Fuga 2,888,690
152	Berat	Spiro Butka 812,000
153	Berat	Petraq Angjellar Simsia4,082,608
154	Elbasan	SPIRO BICI 4,571,820
155	Gjirokastrë	Skender Nelaç 28,700
156	Korçë	Bardhyl Maellari -32,180,574
157	Korçë	PETRIT KRISTAQ KOLE-45,182,205
158	Fier	Luto Behari 10,537,300
159	Fier	Ramadan Merka 73,867,400
160	Fier	Hekuran Gjyshia 3,279,640
161	Vlorë	Besnik Harizaj
162	Kukës	Sazan Shemsi Deda
163	Elbasan	FATMIR BUFI
164	Berat	Dhimitër Qyli 1,092,624
165	Berat	Mitri Arapi 0
166	Berat	Kozma Llambi Stasa 11,409,615
167	Elbasan	SHABAN XHEMALI 1,161,610
168	Tiranë	BARDHYL GORANI 48,113,289
169	Korçë	Vasillaq Petraç Kolaci 850,000
170	Korçë	THIMI ROBO 19,800
171	Gjirokastrë	Bashkim Zace -16,081,314
172	Lezhë	Gjon Llesh Tusha
173	Lezhë	Pjeter Preng Jaku
174	Gjirokastrë	Sefer kaco
175	Lezhë	Zef Ndue Dudi 1,600,940
176	Korçë	Stavri Vasil Kosta 2,409,600
177	Durrës	Sinan Ganaj 96,950
178	Elbasan	LUFTARAKE QATIPI 1,410,000
179	Tiranë	Najada Hoxha 3,458,448
180	Gjirokastrë	Trashëgimtaret 173,360
181	Gjirokastrë	Kujtim Bejra 850,200
182	Shkodër	Bedri Bushati 15,480,000
183	Tiranë	GEZIM SULSAROVA 8,220,800
184	Korçë	Zyflil Xhevit Avdulli 10,295,710
185	Dibër	Lek Rica 634,410
186	Gjirokastrë	Jorgo Qirjaqi 91,200
187	Gjirokastrë	Reit Zeqaj 2,576,448
188	Korçë	SILDA SHYTI 14,650,680
189	Korçë	BASHKIM JASHARI BEKIM GUXHOLLI 1,536,000
190	Tiranë	IDA KRIPA (AGAJ) 71,634,061
191	Fier	Gjergji Dhima 5,824,000
192	Gjirokastrë	Luan Islami 5,054,735
193	Korçë	Ylber Duro 124,000
194	Korçë	AGRON ORHANI
195	Korçë	Çelnik Capo -2,339,372
196	Fier	Vasilefsku Stamo 58,113,900
197	Fier	Illirjan Gjoni 1,099,538
198	Fier	Shefit Zotaj
199	Fier	Osman Jazo 12,623,000
200	Durrës	Mirushe Gobja (Sheqerja)
201	Fier	Fasilli Zdrava
202	Gjirokastrë	Xhavid Omari
203	Gjirokastrë	Elmaz Blliku

2,856,000		
204	Gjirokastrë	Gramoz Blliku
1,116,304		
205	Korçë	EQEREM BAJRAMI 14,310,048
206	Gjirokastrë	Trashëgimtaret
207	Gjirokastrë	Elisabeta Kruja 8,512,000
208	Tiranë	BASHKIM BEKTESI 142,732,800
209	Gjirokastrë	Nado Dudumi
210	Gjirokastrë	Kristaq Nasi 0
211	Korçë	Alfred Molla 2,484,096
212	Elbasan	LULJETA HALILI 3,535,628
213	Dibër	MIRVET NURAJ 72,657
214	Shkodër	Kujtim Marashi
215	Korçë	Flora Apostol Bica 710,000
216	Fier	Sabire Halli 41,217,300
217	Korçë	Agim Danglli 1,749,380
218	Vlorë	Filip Sota 489,600
219	Berat	Jorgji Karaja 28,420,000
220	Berat	Destimona Maksut Zhiiti 11,236,050
221	Korçë	Nardi Martini 345,154
222	Elbasan	JORGJI SANTO 555,000
223	Elbasan	JORGJI SANTO
224	Korçë	Dhimitraq Vasil Ballauri
225	Dibër	NDRECMENGA
226	Lezhë	NDRECMENGA 1,812,726
227	Dibër	NDRECMENGA 474,240
228	Durrës	Eqerem Dedeja
229	Durrës	Eqerem Dedeja
230	Korçë	Vangjel Koço 2,300,000
231	Korçë	Robert Papi-32,820
232	Durrës	Fuat Bilali, Mustafa Fani, Syrry Fani 328,855,200
233	Durrës	Petrit Gjeçi 0
234	Korçë	Kostaq Filip Kajno 1,900,000
235	Durrës	Shpëtim Metani
236	Durrës	Shpëtim Metani 8,646,660
237	Vlorë	Vladimir Gjomeza 0
238	Korçë	Lumturije Shkulaku 5,100,000
239	Korçë	Illirjan Roshanji
240	Korçë	Donika Spiro Ristani 800,000
241	Berat	Mehdi Dervishi
242	Korçë	Vladimir Gjomeza 2,334,528
243	Berat	Përparim Alizoti
244	Berat	Dhimitër Kolovani 28,420,000
245	Berat	Eqerem Risila 125,460,000
246	Tiranë	ETHEM RRAKLLI 1,579,200
247	Tiranë	ETHEM RRAKLLI 8,225,000
248	Berat	-8,423,107
249	Durrës	Eliane Tullon 11,171,374

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Mund të jetë kursemi.
5. Ylli i Nostradamus.
8. Tamam pa kufij.
11. Ross këngëtare.
13. I lashë.
15. Eshhtë Aleanca ku sapoi kemi aderuar.
19. Kufijtë e lëvizjes
20. I ka tek plepi.
21. Paguhen për shërbim.
23. Fillojnë lejen.
24. Kufizojnë trotualet.
25. Bëjnë karrierë në parti.
27. Thahet me bonifikim.
28. Mund të jetë unik një i tillë.
29. Preka komik shkordran.
31. Fund dhjetori.
32. Fillojnë aksionin.
33. Ente Operative Tiranë.
34. Agjenci Ajrore Durrës.
36. Një pjesë e dimensioneve.

39. Eshhtë përfaqësuesja e Adriam Mutu.
41. Kalimi në ekstreme.
42. Eshhtë e re pas Krishtit.
43. Shkruhet për të mos vazhduar më.
44. Si i gjithë .
47. Kush e thotë lutet.
48. Kufij elementi.
49. Ishte nyja që preu Aleksandri i Madh.
50. Një pjesë e titanëve.
51. Mund të jetë kundërmuese.
52. Pak titanike.

VERTIKAL

1. Si i përshatëshëm.
2. Mund të jenë fetare.
3. Ai i kuq e ka një huq.
4. Pak analogji.
6. Eshhtë metri i trobaqepësit.
7. Një hyrje të oazit.
8. Arte pa re.
9. Arthur që qe dramaturg.
10. Janë boshte.
12. Michelangelo regjisor.
14. Mund të bëjë stil të lirë .
16. Ishin monedhe te Tobias.
17. Eshhtë bas me katër tela.
18. Pak efikasitet.
22. Eshhtë marrëveshje me nota.
25. Ishte babai i Akilit.
26. Fillojnë nazet.
27. Në krye të kuadrove.
29. Eshhtë faqe muri.
30. Një apendisit i menjëhershëm.
35. Kurosawa që qe regjisor.
36. Vriten nga espada.
37. Eshhtë shtet aziatik.
38. Edouard piktor.
40. Një transporti është kamioni.
45. Uni i Freud.
46. Një cigan.
47. Fundi i një samurai.

Fjalëkryqi (2)


HORIZONTAL

1. Fillojnë panikun.
3. Gibson aktor.
5. Në mes të cogito dhe sum e thën nga Descartes.
9. Mund të jetë trofe.
11. Janë vendet si Katari
14. Maureen që qe aktore.
16. Janë kundërmuese.
17. Mund të fitojnë etapa.
20. Ushtojnë nga "ola".
22. Një thirrje
26. Janë ministritë.
27. Një rrugë në Paris.
28. Markë cigareje.
29. Eshhtë ngjinja.
32. Ricciarelli soprano.
33. Fillojnë sefte.
34. Ente Ekonomike Sarandë.


35. Mbyllin një ditar.
36. Satelit i Jupiterit
37. I ka tek Luani.
38. Boldi komik italian.
42. Eshhtë kolana në filma
43. Kush e thotë lutet.
44. Oxa këngëtare.
46. Iniciallet e Nolte aktor.
47. Eshhtë tokë që... fitohet.
48. Një... gjermane.

VERTIKAL


1. Një votë në favor.
2. Filozofi me eksperimentin e gomarit.
3. Në hyrje makinës.
4. Fillojnë lehtë.
5. Irlanda në Dublin.
6. Eshhtë edhe ajo e historisë.
7. Një pjesë e gamlijeve
8. Notat pa kufij.
9. Ishin komitë.
10. Ka kryeqytet Islamabad.
12. Don... i Interpretuar nga Terence
13. Mbyllin aktet.
15. Janë përmasa.
18. Gjysma e lujtes.
19. Castellitto aktor.
20. Iniciallet e Dalí, piktor.
21. Tanita këngëtare.
23. Eshhtë tryzni
24. Në hyrje të Europës.
25. Janë rrobat për t'u larë.
30. Bën mëza.
31. Moreau aktor.
32. Janë thika.
39. Një pjesë e satelitit.
40. Janë teke në sende.
41. Pak marramendëse.
42. I ka tek zdapi.
45. Iniciallet e Nolte-s.




Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave



PËRGJIGJET E FJALËKRYQVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)



- Mos e humbni kohën tuaj duke u përpjekur për të shpjeguar, njerëzit dëgjojnë vetëm atë që duan të dëgjojnë.
- Një popull që zgjedh të korruptuar, hajdutë, tradhtarë dhe mashtrues, nuk është viktimë, është bashkëpunëtor i tyre.
- Kur dy njerëz zihen, fajin e ka ai që është më i mençur.
- Kur doni të veproni, duhet të mbyllni portat e dyshimit.
- Duhet patur frikë nga ai që urren vetveten, sepse ti mund të jesh viktimë e zemërimit dhe e hakmarrjes së tij.

Thënie të mençura

- - Sa më shumë që ngrihemi, aq më shumë të vegjël dukemi në vështrimet e atyre që nuk dinë të fluturojnë.
- - Është e lehtë të kesh parime kur je i pasur. Gjë e rëndësishme është të kesh parime kur je i varfër.
- - Drejtësia? Ju do të gjeni drejtësinë në botën tëjetër. Në këtë jetë kemi vetëm ligje.
- - Disa bëhen me turp kundrejt lavdërimeve të mëdha, të tjerët bëhen të paturp.

SUDOKU

			4	9				
	8		6	7				
9		2	8		4			
	9	1						
	4		3	6				2
						5		4
						7		1
	2	8			1		3	
1		3	7		6	8		


Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

1	4	7	2	5	8	3	6	9
8	9	3	1	6	7	4	2	5
2	5	6	4	9	3	1	7	8
3	1	9	5	4	6	2	8	7
4	6	5	7	8	2	9	1	3
7	2	8	9	3	1	5	4	6
5	8	2	6	1	9	7	3	4
6	7	4	3	2	5	8	9	1
9	3	1	8	7	4	6	5	2

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm



- - Sa më shumë që ngrihemi, aq më shumë të vegjël dukemi në vështrimet e atyre që nuk dinë të fluturojnë.
- - Është e lehtë të kesh parime kur je i pasur. Gjë e rëndësishme është të kesh parime kur je i varfër.
- - Drejtësia? Ju do të gjeni drejtësinë në botën tëjetër. Në këtë jetë kemi vetëm ligje.
- - Disa bëhen me turp kundrejt lavdërimeve të mëdha, të tjerët bëhen të paturp.

